AGJENCIA E SIGURIMIT TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË

# RAPORTI I VLERËSIMIT TË JASHTËM

**PROGRAMI I STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL "APLIKACION NE WEB DHE DIZENJIM GRAFIK" OFRUAR NGA INSTITUCIONI I ARSIMIT TË LARTË "UNIVERSITETI "ALEKSANDËR MOISIU", DURRËS**


Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

1. Dr. Blerta Leka (Moçka)
2. Dr. Dorina Arapi


Tetor 2023

## RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

**Për programin e studimit me karakter profesional në** "Programi i Studimit me Karakter Profesional "Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik" **ofruar nga** Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës.

| Nr. | | |
|---|---|---|
| 1 | IAL aplikues: | Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës |
| 2 | Njësia bazë që e ofron: | Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit |
| 3 | Emërtimi i programit të studimit: | Programi i Studimit me Karakter Profesional "Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik |
| 4 | Urdhëri/VKM i licencimit: | UAMSR nr 226 date 10.07.2020 |
| 5 | Urdhëri/VKM i riorganizimit: | |
| 6 | Forma e regjistrimit të diplomës: | |
| 7 | Urdhëri/VBA i akreditimit të parë: | - |
| 8 | Cikli i studimit: | |
| 9 | Kohëzgjatja e programit të studimit: | 2 vjecar |
| 10 | Kreditet në total (ECTS): | 120 etc |
| 11 | Forma e studimit: | Me kohë të plotë |
| 12 | Gjuha (shqip/tjetër): | shqip |
| 13 | Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera: | - |
| 14 | Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin): | - |
| 15 | Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin): | - |
| 16 | Niveli në kornizën kombëtare të kualifikimeve: | Përmbajtja e programit të studimit është në përshtatje me pritshmëritë e kërkesat e tregut e punës, në përputhje me nivelin 5 të KSHK. |
| 17 | Stafi akademik PAE/PAK për programin e studimit: | **Stafi akademik PAE/PAK**<br><br>**Viti akademik 2022-2023**<br>• PAE 23 pedagogë<br>• PAK –<br>**Viti akademik 2022-2021**<br>• PAE 23 pedagogë<br>• PAK –<br>**Viti akademik 2021-2020**<br>• PAE 23 pedagogë<br>• PAK – |
| 18 | Numri i studentëve: | **Numri i diplomuarve 2021-2022**<br>• **Total 4**<br>Numri i studentëve të regjistruar 2020-2021<br>• **54 studentë**<br>Numri i studentëve të regjistruar 2021-2022<br>• **61 studentë**<br>Numri i studentëve të regjistruar 2022-2023<br>• **45 studentë** |
| 19 | Komente / të tjera: | |

**PËRMBLEDHJE E TE DHËNAVE PËR PROGRAMIN NË PROCES TË VLERËSIMIT TË JASHTËM**

Universiteti "Aleksandër Moisiu", Durrës, është themeluar në vitin *2006* me Vendimin e Këshillit të Ministrave, *Nr. 801*, datë *20.12.2005* "Për hapjen e Universitetit *"Aleksandër Moisiu"*, Durrës" dhe ofron programin e studimit 2 vjecar në *"Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik"*. Ky program studimi ofrohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike që është një nga tre njësitë bazë përbërëse të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. FTI është krijuar me Vendim të Këshillit të Ministrave *Nr.685*, datë *25.08.2010*.

Programi profesional 2- vjeçar është një program studimi bashkëkohor që synon të formojë dhe të përgatisë specialistë në fushën e dizenjimit & krijimit të faqeve Web dhe dizenjimit grafik. Ky program studimi është projektuar duke menduar për të rinjtë që kanë përfunduar arsimin e mesëm dhe dëshirojnë të përftojnë një profesion bashkëkohor duke ju bashkuar në një kohë më të shkurtër tregut të punës.

**PËRSHKRIMI I PROCESIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM;**

Ditën e parë, u realizuan:

- Takimi me Dekanin e Fakultetit
- Përgjegjësin e Departamentit;
- Takimi me Grupin e vetëvlerësimit;
- Takim me Përfaqësues të Komisionit të Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe zyrës së kurikulave;
- Takim me stafin akademik të angazhuar në këtë program studimi (të brendshëm dhe të jashtëm);
- Takimi përmbyllës i ditës së parë.

Ditën e dytë u realizuan:

- Takim me përfaqësues të zyrës së burimeve njerëzore;
- Takim me studentët e këtij program studimi;.
- Vizitë në sekretarinë mësimore
- Vëzhgim i mjediseve (auditorët, laboratorët, dhe shërbimet për studentët etj.) Vizitë në Bibliotekë.
- Takimi përmbyllës me Përgjegjësin e Departamentit

Hartimi i Draft raportit të vlerësimit të jashtëm dhe dërgimi i tij në Institucion.

Komisioni I vlerësimit të jashtëm kreu biseda me stafin akademik, administrativ dhe studentët e këtij program, dhe vizitoi laboratorwt ky kryheshin lwndwt laboratorike.
Vizita në institucion u krye sipas agjendës së programuar.
Znj. Anilda Beqiraj ishte Koordinatore Teknike e ASCAL. Në sistemin e Ascal mund të aksesoheshin dosja dhe dokumentet e Vetëvlerësmit. Vizita në institucion u krye në qershor 2023.

**Vlerësimi i Programit të studimit me karakter profesional në "Aplikacion në Web dhe Dizenjim Grafik"**

## I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi I.1**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ofron programe studimi që nuk bien ndesh me interesat kombëtare dhe synojnë ruajtjen dhe konsolidimin e vlerave akademike e kulturore kombëtare. | Universiteti "*Aleksandër Moisiu*" Durrës ofron programin e studimit 2 vjecar në *"Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik"*, qe ofrohet nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike e që është një nga tre njësitë bazë përbërëse të Fakultetit të Teknologjisë së Informacionit. Programi i studimit profesional-2 vjeçar "Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik" është në përputhje me qëllimet dhe misionine Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) si dhe në përputhje të plotë me fushën e veprimtarisë së FTI dhe Departamentit të Shkencave Kompjuterike (DSHK). Institucioni ofron programe studimi në përputhje me interesat dhe vlerat kombetare qe mbeshtesin e promovojne vlerat akademike te arsimit ne Shqiperi.<br>Evidenca nr 1. Propozimi i Departamentit të Shkencave Kompjuterike.<br>2. STATUTI-MIRATUAR-UAMD.<br>3. Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025.<br>https://uamd.edu.al/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit/<br>https://uamd.edu.al/departamenti-i-shkencave-kompjuterike/ |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit, si dhe fushën e veprimtarisë. | Programi i studimit profesional-2 vjeçar "Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik" është në përputhje me qëllimet dhe misionin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) si dhe në përputhje të plotë me fushën e veprimtarisë së FTI dhe Departamentit të Shkencave Kompjuterike (DSHK). Institucioni ofron programe studimi në përputhje me misionin si dhe fushen e veprimtarise se intistucionit.<br>Evidenca 2. STATUTI-MIRATUAR-UAMD.<br>Evidenca 23. Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025. |
| **Kriteri 3.** Programi i studimit hartohet dhe ofrohet në përshtatje dhe në zbatim të strategjisë për zhvillim, të Statutit dhe Rregullores së Institucionit si dhe me fushat e drejtimet akademike të tij. | Programi i studimit profesional-2 vjeçar "Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik" është hartuar dhe ofrohet në përputhje më zhvillimin strategjik të universitetit, bazuar në Statutit dhe rregulloren e tij, si dhe dhe fushat akademike qe institucioni ofron. Programi i studimit formon specialistë dhe profesionistë në fushën e "Aplikimit ne Web dhe Dizenjimit Grafik" duke ofruar një program studimi që i aftëson studentët për një nga profesionet më të kërkuara nga tregu i punës dhe me një perspektivë në rritje për të ardhmen. Programi i studimit profesional-2 vjeçar "Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik" është një nga programet e studimit me numrin më të madh të aplikanteve në FTI.<br>https://uamd.edu.al/departamenti-i-shkencave-kompjuterike/<br>https://uamd.edu.al/aplikacion-Web-dizenjim-grafik/<br>Evidenca 2. STATUTI-MIRATUAR-UAMD.<br>Evidenca 3. Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025. |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit hartohet e zhvillohet mbështetur në studime të mirëfillta mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe. | Programi i studimit profesional-2 vjeçar "Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik" është hartuar mbështetur në studime mbi tregun lokal e kombëtar të punësimit për këto programe. Programi i studimit profesional-2 vjeçar "Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik" është një nga programet e studimit me numrin më të madh të aplikanteve në FTI.<br>Kjo gjë dëshmon nevojën e tregut të punës, dhe dijeve te tregut bashkëkohor e global për nevojën e këtyre profesioneve që lidhen me teknologjinë. Universiteti dhe fakulteteti, duke qenë se janë të orientuar drejt teknologjisë |

| | |
|---|---|
| | e shkencave kompjuterike, kanë bërë hulumtime paraprake për nevojën dhe ngritjen e këtij program studimi për ata studentë që kanë nevojë ti qasen tregut të punës në rrugë të shpejtë, të aksesueshme e të aplikueshme. Institucioni ka zhvilluar një analizë ku paraqet qëllimin dhe arsyetimin për hapjen e këtij programi. Kërkesa në rritje që tregu i kërkon IAL-ve për të oftuar programe studimi profesionale. Në vitet e fundit politikat e arsimit i kanë kushtuar një vëmendje të veçantë zhvillimit të arsimit profesional të lartë. Një nga masat e marra në këtë drejtim është edhe vendosja e nivelit minimal të mesatares skualifikuese (mesatere VKM) për maturantët që aplikojnë për studime të larta në IAL-të në Shqipëri.<br><br>Evidenca 2. STATUTI-MIRATUAR-UAMD.<br>Evidenca 3. Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025.<br>Evidenca 4. Dosja e programit - Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik.<br>Evidenca 5. Rregullore IAL UAMD.<br>Evidenca 6. Rregullore FTI.<br>1. Propozimi i Departamentit të Shkencave Kompjuterike |
| **Kriteri 5.** Institucioni demonstron se ka përvojën, kapacitetet dhe burimet e duhura në fushën akademike specifike për ofrimin e një programi studimi në atë fushë. | Institucioni dëshmon se ka një përvojë të gjatë disa vjecare në zhvillimin e progresin akademik në këto fusha, si dhe ka burimet njerëzore për ofrimin e këtij programi. FTI dhe DSHK plotësojnë kriteret ligjore në lidhje me numrin e personelit akademik si dhe të titujve/gradave shkencore. Fakulteti ka krijuar një qëndrueshmëri akademike si në numrin e personelit akademik me tituj / notë shkencore, por edhe në profilizimin e tyre në kurset e lidhura duke pasur edhe një teknikë të lartë në mësimdhënie.<br>Evidenca 2. STATUTI-MIRATUAR-UAMD.<br>Evidenca 3. Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025. |
| **Kriteri 6.** Fusha e përgjithshme dhe specifike e programit të studimit duhet të jetë në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane. | Programi i studimit profesional-2 vjeçar "Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik" është në përputhje të plotë me qëllimet dhe misionin e Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës (UAMD) si dhe në përputhje të plotë me fushën e veprimtarisë së FTI dhe Departamentit të Shkencave Kompjuterike (DSHK). Programi i studimit është në përputhje me fushën akademike e kërkimore të njësisë/ve përgjegjëse për programin e studimit, sipas klasifikimit/ kodifikimit të programeve të studimit, sipas direktivave dhe udhëzimeve kombëtare e evropiane.<br>Evidenca 5. Rregullore IAL UAMD.<br>Evidenca 6. Rregullore FTI.<br>Evidenca 7. Rregulloret PSP Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik<br>Evidenca 2. STATUTI-MIRATUAR-UAMD<br>https://uamd.edu.al/aplikacion-Web-dizenjim-grafik/ |
| **Konkluzione** | *UAMD ofron programe studimi në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij, me fushën akademike të njësisë kryesore dhe bazë përgjegjëse për programin e studimit, e që synon ruajtjen e interesave dhe vlerave kombëtare.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.2**<br>**Institucioni i arsimit të lartë siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni për hartimin, mbikëqyrjen dhe mbarëvajtjen e programit, siguron marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi brenda institucionit nëpërmjet ndarjes së detyrave mes njësive e personelit, marrjes së përgjegjësive përkatëse dhe analizës së vazhdueshme të | Programi me karakter Profesional "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik" ka strukturë organizative:<br>• Organet drejtuese<br>• Departamenti i Shkencave Kompjuterike,<br>• Koordinatori i Programit të studimit<br>• Komisionet<br>• Personeli akademik<br>Departamenti i Shkencave Kompjuterike, që luan rol të rëndësishëm në |

| | |
|---|---|
| punës së tyre. | organizimin e programit, miraton strategjinë e zhvillimit, propozon planin mësimor, miraton strukturën e studimeve, kriteret e pranimit të studentëve dhe ndjek zbatimin e tyre, projektet e studentëve për temën e diplomës dhe / ose strukturën e tezës për provimin e diplomimit. Në sajë të strukturës organizative, dhe kordinimit e përcaktimit të detyrave përkatëse, institucioni mbikqyr mbarëvajtjen e programit, dhe zhvillimin e mëtejshëm të tij dhe përmbush misionin e tij nëpërmjet bashkëpunimeve më institucione të ndryshme.<br><br>Evidenca Neni 10 Detyrat e organit drejtues |
| **Kriteri 2.** Për realizimin e objektivave e procesit mësimor e formues të studentëve, institucioni vendos marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe brenda dhe/ose jashtë vendit, aktorët e biznesit vendës dhe/ose të huaj. | UAMD-ja ka nënshkuar mbi 100 Marrëveshje Bashkëpunimi me universitete, institucione dhe biznese brenda dhe jashtë Shqipërisë, më shumë se gjysma e tyre janë me institucione të arsimit të lartë, 59 prej të cilave janë nënshkruar me universitete të huaja, gjithashtu dhe 67 Marrëveshje Ndërinstitucionale me Universitete Evropiane në kuadër të komponentit International Credit Mobility Erasmus+.<br>Për realizimin e objektivave dhe procesit mësimor, zhvillimin e praktikave mësimore dhe profesionale etj., FTI ka lidhur marrëveshje bashkëpunimi me institucione partnere, me biznese të fushës si dhe ka aplikuar në projekte kombëtare dhe ndërkombëtare që ofrojnë fonde për realizimin e objektivave të mësipërme. Këto marrëveshje përfshijnë edhe pjesën e praktikës mësimore dhe profesionale si në ambjentet e FTI ashtu edhe për praktikat profesionale pranë bizneseve partnere, investimet në infrastrukturë, trajnimin e studentëve dhe personelit akademik, shkëmbimin e studentëve dhe njohjen e krediteve për periudhat e shkëmbimit etj.<br>https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/01/Internalization-Strategy-of-UAMD.pdf<br>https://uamd.edu.al/marredheniet-me-jashte-dhe-projektet/<br>https://uamd.edu.al/projektet-aktuale/<br>https://uamd.edu.al/marreveshjet-nderinstitucionale-erasmus/<br>https://uamd.edu.al/marreveshjet-kombetare-nderkombetare-2/<br>Evidenca 13. Marreveshjet Uamd.<br>Evidenca 21. Universitetet partnere |
| **Kriteri 3.** Për realizmin e programit të studimit, institucioni nënshkruan marrëveshje të posaçme, afatgjata e të qëndrueshme me institucione, kompani të fushës përkatëse për realizimin e praktikave profesionale, klinike, praktikave të punës etj, dhe bashkëpunon me to për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës. | Për shkak të natyrës së këtij programi studimi dhe të kurseve që përmban praktikat mësimore zhvillohen kryesisht në ambjentet e FTI falë dhe investimeve në infrastrukturë që ky fakultet ka bërë për këtë qëllim. Institucini ka të përfshirë në sistemin e tij dhe strategjinë e ndërkombëtarizimit. Kjo pasqyrohet dhe në faqen online të tij.<br>FTI zotëron 6 laboratorë profesional të cilat ndohmojnë në zhvillimin e praktikave profesionale. Ato janë të paraqitura, si më poshtë:<br>• 3 laborator kompjuterik për zhvillimin e praktikave mësimore përprogramim<br>• 1 laborator kompjuterik për zhvillimin e praktikave mësimore përdizenjimin grafik<br>• 2 laboratorë profesional për zhvillimin e praktikave profesionale, përzhvillimin e projekteve dhe punimit të diplomës.<br>3 laboratorët për praktikat mësimore (Sallat 101, 111 dhe 211) kanë70 njësi pune në total dhe janë një investim që FTI ka përftuar falë bashkëpunimit me kompani private (Crystal System Group).<br>Laboratori për praktikat mësimore për dizenjimin grafik (salla 203) ka20 njësi pune dhe është ndërtuar nga pjesëmarrja e FTI në projekte ndërkombëtare Erasmus Plus.<br>Në bazë të këtyre projekteve, institucioni ka krijuar edhe laboratorin për zhvillimin e praktikave profesionale në fushën e multimedias (salla 103), si dhe një laborator kërkimor për zhvillimin e praktikave profesionale si pjesë e projekteve të AKSHI me 20 njësi pune (salla 015).<br><br>Evidenca 28. Laborator FTI.<br>Evidenca 4. Dosja e programit - Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik |
| **Kriteri 4.** Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e | Në zbatim të nenit 103 të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Senati Akademik i UAMD ka miratuar Rregulloren eSistemit të Brendshëm të |

| | |
|---|---|
| studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. | Sigurimit të Cilësisë ku përcaktohet se njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është Drejtoria e Kurrikulave & Standarteve të Cilësisë. Misioni i kësaj Drejtorie/NjBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të UAMD dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim.<br>https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/<br>Në mënyrë periodike, njësia përgjegjëse për programin e studimit harton raporte analitike të përfitimeve nga marrëveshjet e bashkëpunimit në funksion të realizimit të programit të studimit. |
| **Kriteri 5.** Institucioni ndërmerr iniciativa specifike në mbështetje të sipërmarrjes dhe punësimit të studentëve. | Në bazë të marrëveshje që institucioni ka krijuar me institucione të tjera, bizneseve partnere, janë mundësi punësimi për studentët e këtij programi. Institucioni ka të ngritur dhe Sektorin e Karrierës dhe Alumnit, që iu ofro studentëve informacion dhe trajnim (mbi situatën në tregun e punës, përgatitjen e CV-së profesionale, letrës së motivimit, etj.).<br>Ky sektor punon në mënyrë të vazhdueshme me studentët në përmirësimin e njohjes së cilësive të tyre (identifikimi i pikave të forta dhe të dobëta, ndërgjegjësimi për aftësitë e tyre), dhe I ofron atyre mundësi për zhvillimin e kompetencave të tyre.<br>Sektori fokusohet në disa aspekte si:<br>• Këshillim karriere<br>• Trajnime mbi hartimin e jetëshkrimit, letrës së motivimit dhe përgatitjen për intervistën e punës<br>• Informim për mundësi punësimi<br>• Seminaret e zhvillimit personal<br>• Praktika pune dhe punë vullnetare<br>• Panairi i Punës dhe i Karrierës<br>• Job Shadoëing<br>• "Çmimi i Karrierës" për Alumni-t<br>• Seria "Alumni Talks"<br>Fakulteti ka dhe një udhëzues për karrierën e studentit, që iu vjen në ndihmë studentëve dhe alumnit në procesin e kërkimit dhe aplikimit për punë. Informacioni dhe ushtrimet në të iu vlejnë atyre edhe për t'u përgatitur për këshillimin e personalizuar nga këshilluesit e karrierës në UAMD.<br>https://www.uamd.edu.al/ëp-content/uploads/2022/07/UAMD-Udhezues-nga-Qendra-e-Karrieres-dhe-Alumni-21-Maj-2020.pdf<br>https://uamd.edu.al/karriera/ |
| **Konkluzione** | *UAMD siguron marrëdhënie bashkëpunimi me institucione, kompani, palë të treta, aktorë të biznesit vendas dhe/ose të huaj në funksion të realizimit të programit të studimit, në kuadër të aftësimit profesional, dhe mobilitetit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi I.3**<br>**Institucioni i arsimit të lartë harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni i arsimit të lartë ka politika, struktura dhe procedura për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (SBC), në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe me aktet rregullatore institucionale. | Në zbatim të nenit 103 të Ligjit të Arsimit të Lartë dhe Kërkimit Shkencor, Senati Akademik i UAMD ka miratuar Rregulloren eSistemit të Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë ku përcaktohet se njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është Drejtoria e Kurrikulave & Standarteve të Cilësisë. Misioni i kësaj Drejtorie/NjBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të UAMD dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim.<br>**https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/**<br>Në faqen online te institucionit pasqyrohen dhe informacionet e kesaj njësie, dokumente dhe informacione si: |

| | |
|---|---|
| | • Njësia e Brendshme e Sigurimit të Kjosë (UAMD)<br>• Regullore dhe NJSBC.<br>• Marrëdhënia në NJSBC.<br>• Pyetësor mbi mësimdhënien online.<br><br>https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf |
| **Kriteri 2.** Institucioni ka të ngritur dhe mban në funksion Sistemin e Brendshëm të Sigurimit të Cilësisë duke zbatuar rnjë strategji institucionale për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë, ku përfshihen studentët dhe bashkëpunëtorë e ekspertë të jashtëm. | Njësia përgjegjëse për sigurimin e brendshëm të cilësisë është Drejtoria e Kurrikulave & Standarteve të Cilësisë. Misioni i kësaj Drejtorie/NjBSC është planifikimi i përmirësimit të vazhdueshëm të UAMD dhe realizimi i proceseve që e garantojnë këtë përmirësim.<br>https://uamd.edu.al/njsbc-uamd/<br><br>Struktura dhe funksionet e kësaj njësie përcaktohen ne statutin e institucioneve të arsimit të lartë. NjSBC harton standardet për sigurimin e cilësisë së brendshme në përputhje me Kodin e Cilësisë dhe realizon vlerësime periodike për veprimtarinë mësimore dhe kërkimore shkencore. Detyrë e kësaj njësie është gjithashtu realizimi i pyetësorit të studentëve çdo fund semestri, mbi cilësinë e mësimdhënies për lëndët e çdo programi të ofruara nga IAL. Në përbërjen e kësaj njësie është i pranishëm dhe një student si dhe një koordinator për IAL-ASCAL. Në faqen online pasqyrohet dhe pyetësori i studentëve, relacione mbi zhvillimin e lëndëve e procasit mësimor, rregullorja e njësisë.<br>https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Pyetesor-mbi-mesimdhenien-Online.pdf<br><br>Evidenca 17. Rregullore NJSBC.<br>Evidenca 18. Urdher per ngritjen e NjSBC |
| **Kriteri 3.** Institucioni përdor instrumentet dhe treguesit e duhur për sigurimin e cilësisë. Sigurimi i jashtëm i cilësisë në arsimin e lartë realizohet përmes proceseve të vlerësimit të jashtëm të akreditimit, vlerësimeve analitike e krahasuese, si dhe proceseve të tjera që promovojnë e përmirësojnë cilësinë. | Njesia e NJSBC, nëpërmjet rregullores së saj, arrin të koordinojë dhe të përdorë instrumentët me qëllim për të rritur cilësinë përmes përmirësimit të sistemit të kontrollit të brendshëm. Gjithashtu universiteti nëpërmjet sistemit dhe njësive të tij, arrin të sigurojë proceset e treguesve të cilësisë në kuadër të "vlerësimit të jashtëm", duke respektuar hapat e nevojshëm për proceset që lidhen me cilësinë e institucionit, në përputhje me ligjin për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë.<br>Rregullorja bazohet në: - Ligjin Nr.80/2015, "Për arsimin e lartë dhë kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 103,104, 106 dhe 46; - Kodin e Cilësisë në Arsimin e Lartë, miratuar me VKM Nr.531, datë 11.9.2018 ; - Standardet dhe Udhëzimet Europiane për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (SUE) ; - Statutin e Universitetit « Aleksandër Moisiu » Durrës ; - Rregulloren e Universitetit « Aleksandër Moisiu » Durrës ; - Manualin e ASCAL për Sistemin e Brendshëm të Cilësisë;<br><br>17. Regullore NJSBC.<br>18. Urdher per ngritjen e NjSBC |
| **Kriteri 4.** Institucioni përdor tregues të qartë, të matshëm në mësimdhënie dhe kërkim, për pasqyrimin e gjendjes, arritjeve dhe dobësive, të parashikuara dhe në aktet rregullatore institucionale. Mbi bazën e treguesve cilësorë, institucioni bën promovime nxitëse për arritjet më të mira. | Për të realizuar këtë kriter, institucioni ka ngritur struktura përgjegjëse të cilat sigurojnë cilësinë dhe mbarëvajtjen e objektivave të programeve. E tillë është struktura e NJSBC, e cila realizon pyetësorë, anketimeve, raporte duke përdorur tregues të qartë të cilët parashtrojnë pikat e forta, të dobëta, aspekte të ndryshme të mësimdhënies, zhvillimit të programeve, dhe ecurisë akademike.<br><br>Evidenca 17. Rregullore NJSBC.<br>Evidenca 18. Urdher per ngritjen e NjSBC |
| **Konkluzione** | *UAMD harton dhe zbaton politika e procedura transparente të posaçme për sigurimin e cilësisë së programit të studimit, në kuadër të strukturave e sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë.* |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës I | [redacted] | Përmbushet pjesërisht | Përmbushet kryesisht | Përmbushet plotësisht |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

## II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL

| **Standardi II.1**<br>**Programi i studimit organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Programet e studimit janë të organizuara në lëndë e module. Elementet që përbëjnë strukturën e programit të studimit me karakter profesional, janë përcaktuar qartë në përputhje me legjislacionin vendas në fuqi dhe me Sistemin Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS). | Plani mësimor i programit 2 vjecar profesional Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik përmban të gjithë elementët e kërkuar nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Ky program është i organizuar në:<br>- 19 lëndë me frekuentim të vlerësuara përkatësisht nga 6 kredite secila<br>- Provimin / temën e diplomimit që është vlerësuar me 6 kredite<br>Në programin 2 vjecar Aplikacion ne Web dhe Dizenjim Grafik mësimi zhvillohet<br>• **A** LËNDE BAZË **15% - 18 etc**<br>• **B** LËNDË KARAKTERIZUESE **55% -66 etc**<br>• **C** LËNDË NDËRDISIPLINORE/ INTEGRUESE **15%- 18 etc**<br>• **D** LËNDË PLOTËSUESE **10% -12 etc**<br>• **E** DETYRIME PËRMBYLLËSE **5% - 6 etc**<br>Procesi mësimor organizohet në katër semestra të rregullt me kohëzgjatje 16 javë dhe me garkesë 30 kredite për semestër (2 vite akademike). Çdo semestër përmban 5 lëndë (4 me detyrim dhe 1 me zgjedhje) me përjashtim të semestrit të fundit që përmban 4 lëndë (3 me detyrim dhe 1 me zgjedhje) si dhe detyrimet përmbyllëse të provimit / temën e diplomës.<br>Ngarkesa për çdo lëndë me frekuentim është 45 orë në auditor dhe 105 orë studim individual. Frekuentimi dhe mënyra e vlerësimit të studentëve është e unifikuar për të gjitha kurset. Frekuentimi i orëve mësimore është i detyrueshëm në masën 75%. Shkalla e përvetësimit të programit mësimor vlerësohet me sistem pikëzimi prej 1000 pikësh, i cili konvertohet me notë në proces-verbalin përfundimtar ku nota kaluese më e ulët është nota pesë e cila korespondon me 51% të pikëve të fituara. Vlerësimi bëhet përgjatë semestrit dhe bazohet në totalin e pikëve të grumbulluara nga:<br>1. Provimi i ndërmjetëm (40%)<br>2. Provimi përfundimtar (50%)<br>3. Projektet / detyrat e kursit (10%)<br>https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2022/11/AWDG.pdf<br>Evidenca 7. Rregulloret PSP Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik<br>Evidenca 8. Plani mesimor<br>Evidenca 9. Programet e Lëndëve.<br>Evidenca 7. Rregullore e programit te studimit AWDG |
| **Kriteri 2.** Programi i studimit synon formimin e shprehive të veçanta në larmi të gjerë profesionesh e specialitetesh, jep njohuri të përparuara në një fushë studimi ose punësimi, ku përfshihet të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale, të nevojshme për zgjidhjen e | Në planin mësimor të programit të studimit 2- vjecar Aplikacion në Web dhe Dizenjim Grafik mbi 50 % e lëndëve kanë karakter profesional të cilat zhvillohen në laboratorët zotëron FTI. Lëndët si : Përpunim Imazhi, Adobe Illustrator, HTML dhe CSS, Adobe Indesign, Php & MySql, Ëord Press etj janë me karakter praktik. Objektivi përfundimtar i këtij programi studimi është që të formojë profesionistë në fushën e Aplikacioneve Web dhe Dizenjimit Grafik, që synojnë të kuptuarit kritik të teorive dhe parimeve akademike të fushës, zhvillon njohuri, aftësi dhe kompetenca të përparuara në një fushë profesionale.<br>Evidenca 8. Plani mesimor<br>Evidenca 9. Programet e Lëndëve. |

| | |
|---|---|
| problemeve praktike në një fushë të specializuar profesionale. | |
| **Kriteri 3.** Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin profesional të studentëve, ku përfshihen dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që e karakterizojnë profilin profesional të programit. | Përmbajtja e lëndëve përshtatet plotësisht me emërtimin e tyre. Përmbajtja e programit të studimit si dhe shpërndarja e zhvillimit të lëndëve realizohet për të arritur aftësimin e studenteve bazuar nënivelin e vështirësisë së lëndëve, ndërlidhjen midis tyre dhe kërkesat e tregut të punës. Të gjitha lëndët karakterizuese si dhe një pjesë e lëndëve ndërdisiplinore (Unix/Linux, Adobe In Design dhe Animim Kompjuterik) kanë karakter të formimit praktik të studentëve. Këto kurse nëpërbërje të programit të tyre mësimor parashikojnë 25%-30% të ngarkesës në funksion të aftësimit të studentëve në praktikë.<br>https://uamd.edu.al/shkembime-staf-studente-erasmus/<br>Evidenca 2. STATUTI-MIRATUAR-UAMD.<br>Evidenca 3. Plani-i-Zhvillimit-Strategjik-2020-2025.<br>Evidenca 8. Plani mesimor<br>Evidenca 9. Programet e Lëndëve |
| **Kriteri 4.** Programi i studimit ka të përcaktuar ngarkesën në kredite për të gjitha lëndët/modulet, duke përfshirëdhe kreditet për realizimin e praktikës profesionale dhe të detyrimeve përmbyllëse. | Programi me karakter Profesional "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik" realizohet në 2vite akademike, i ndarë në 4 semestra gjatë të cilëve studenti fiton 120 kredite ETCS dhe realizon rreth 3000 orë punë. Veprimtaria mësimore realizohet nëpërmjet orëve të integruara teorike dhe praktike: leksioneve, seminareve, ushtrimeve, detyrave të kursit, prezantimeve, projekteve të kërkimit, praktikës.<br>Për të fituar diplomën në programi me karakter profesional "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik" studenti duhet të mbrojë provimin e diplomimit ose punim diplome, qe permban 6 kredite. Studenti ka të drejtën e mbrojtjes së provimit/punimit të diplomës nese ka marrë vlerësime pozitive në të gjitha lëndët mësimore, duke fituar 114 kreditet e nevojshme dhe pëembushur detyrimet e nevojshme ligjore.<br><br>Evidenca 8. Plani mesimor<br>Evidenca 9. Programet e Lëndëve |
| **Kriteri 5.** Forma e organizimit të studimeve, pranimi i studentëve dhe financimi në institucionet e arsimit të lartë me status të veçantë realizohen në përputhje me ligjin e arsimit të lartë dhe specifikat përkatëse, të përcaktuara në kuadin ligjor të ministrisë përgjegjëse për arsimin. | Çdo vit akademik, për të ndjekur Programi me karakter Profesional "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik" pranohen studentë nga Shqipëria, Kosova, Preshevë-Bujanovca, ish Republika Jugosllave e Maqedonisë, Serbia e Mali i Zi dhe nga vende të tjera. Pranimi i kandidatëve bëhet me konkurim, dhe përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës që nënkupton vlerësimin tërësor të treguesve të kandidatit.<br>Kriteret e konkurimit propozohen nga Departamenti i Shkencave Kompjuterike, vendosen nga dekanati dhe ndiqen nga komisioni i përzgjedhjes. Organizimi i konkursit të pranimit bëhet nga komisioni ad-hoc dhe mbikqyret nga Koordinatori i Programit mbi bazën e Rregullores së Brendshme dhe të vendimeve të autoriteteve drejtuese të institucionit. Për përzgjedhjen e kandidatëve vepron Komisioni i Vlerësimit, i cili i paraqet për miratim Përgjegjësit të DSHK listën e kandidatëve fitues. Komisioni shpall listën e kandidatëve të pranuar.<br><br>Evidenca Neni 24, Proçedurat e pranimit të dokumentave |
| **Kriteri 6.** Programet e studimit me karakter profesional, që ofrohen në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, duhet të kenë përmbajtje të ngjashme në nivel, së paku 70 për qind. | Programi i studimit ofrohet në të njëjtën fushë studimi, si dhe me të njëjtën emërtesë, dhe kanë përmbajtje të ngjashme. Njësia bazë që e ofron këtë programit studimi është Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit. Për shkak të natyrës së tij ndërdisiplinore qendron një bashkëpunim i ngushtë edheme Departamentin e Teknologjisë së Informacionit (pjesë e të njëjtit fakultet) që mbulon kryesisht pjesën e dizenjimit grafik.<br><br>Evidenca 2. STATUTI-MIRATUAR-UAMD. |
| **Kriteri 7.** Programi i studimit shoqërohet me kodin përkatës, sipas fushës së studimit dhe klasifikimeve të bëra publike nga ministria | Programit të studimit profesional "Aplikacion Web Dhe Dizenjim Grafik" është pjesë e studimeve me karakter profesional të lartë referuar nivelit 5 të Kornizës Shqiptare të Kualifikimeve në strukturën akademike të Departamentit të Shkencave Kompjuterike në Fakultetin e Teknologjisë së |

| | |
|---|---|
| përgjegjëse për arsimin. Më tej kryhet kodifikimi i lëndëve të programit. | Informacionit të Universitetit "Aleksandër Moisiu" Durrës.<br><br>Evidenca 2. STATUTI-MIRATUAR-UAMD. |
| **Konkluzione** | *Programi i studimit profesional "Aplikacion Web Dhe Dizenjim Grafik" organizohet në përputhje me parashikimet ligjore e nënligjore në fuqi dhe akteve të brendshme rregullatore.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | X |

| **Standardi II.2**<br>**Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi për organizimin dhe strukturën akademike, stafet akademike vlerësimin dhe akreditimin. | Njësia bazë që e ofron këtë programit studimi është Departamenti i Shkencave Kompjuterike, Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit. Për shkak të natyrës së tij ndërdisiplinore qendron një bashkëpunim i ngushtë edhe me Departamentin e Teknologjisë së Informacionit (pjesë e të njëjtit fakultet) që mbulon kryesisht pjesën e dizenjimit grafik.<br><br>Evidenca 6. Rregullore FTI.<br>Evidenca 7. Rregulloret PSP Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik |
| **Kriteri 2.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike e klinike, etj. | Për mbarëvajtjen e veprimtarisë së programit të studimit profesional "Aplikacion Web Dhe Dizenjim Grafik" kanë përgjegjësitë e tyre: Departamenti i Shkencave Kompjuterike dhe Fakulteti i Teknologjisë së Informacionit.<br>Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit përmbush detyrimet e përcaktuara në legjislacionin në fuqi, duke angazhuar personel ndihmës akademik /administrativ për realizimin e praktikave mësimore, laboratorike .<br>Evidenca 2. STATUTI-MIRATUAR-UAMD.<br>Evidenca 5. Rregullore IAL UAMD.<br>Evidenca 6. Rregullore FTI.<br>Evidenca 7. Rregulloret PSP Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik |
| **Kriteri 3.** Njësia kryesore/bazë përgjegjëse për programin e studimit, për çdo program studimi cakton një person në rolin e koordinatorit të programit të studimit, i cili është përgjegjës për ecurinë dhe zhvillimin e programit dhe praktikave profesionale në përputhje me objektivat e tij. | Koordinatori i programit ka një rol kyç në sigurimin e cilësisë së programeve akademike në UAMD dhe siguron garantimin e suksesit të studentëve në universitet, duke kordinuar punën në dekanatet, përgatitjen e raporteve vjetore kur kërkohet nga NjBSC-ja gjatë një procesi akreditimi; Përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme studimin e tregut mbi programin që mbikëqyr; Përgatit dhe rifreskon në mënyrë të vazhdueshme dosjen e programit që mbikëqyr.<br>Evidenca 6. Rregullore FTI.<br>Evidenca 7. Rregulloret PSP Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik |
| **Konkluzione** | *Departamenti i Shkencave Kompjuterike përgjegjëse për programin e studimit përmbush kërkesat ligjore dhe standardet e cilësisë për këto njësi.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | x |

| **Standardi II.3**<br>**Programi i studimit është i detajuar, informues, i strukturuar dhe organizuar në përputhje me parashikimet dhe objektivat formuese të programit me karakter profesional.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Njësia kryesore/bazë, përgjegjëse për programin e studimit me karakter profesional, disponon informacionet e nevojshme për | Bazuar në rregulloren e programit, programi me karakter Profesional "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik" ka këtë strukturëorganizative:<br>I. Organet drejtuese<br>o Departamenti i Shkencave Kompjuterike, |

| | |
|---|---|
| organizimin, strukturën dhe përmbajtjen e programit të studimit. | o Koordiantori i Programit të studimit<br>II. Komisionet<br>III. Personeli akademik<br><br>Departamenti i Shkencave Kompjuterike ka këto detyra:<br>a) Miraton Rregulloren e brendshme të programit të studimit profesional 2 vjeçar<br>b) Miraton strategjinë e zhvillimit.<br>c) Propozon planin mësimor, të cilin ia paraqet për diskutim Dekanatit të Fakultetit dhe përmiratim Senatit Akademik.<br>d) Miraton strukturën e studimeve.<br>e) Miraton kriteret e pranimit të studentëve dhe ndjek zbatimin e tyre.<br>f) Miraton projektet e studentëve për temën e diplomës dhe / ose strukturën e tezës për provimin e diplomimit<br>g) I propozon Dekanit vendosjen e lidhjeve me shkollat analoge vendase dhe të vendeve të huaja, anëtarësimin në shoqata kombëtare e ndërkombëtare që kanë si objekt, çështje të arsimit të lartë dhe të integrimit evropian.<br><br>DSHK u jep studentëve gjithë informacionin e nevojshëm lidhur me rregulloren, strategjinë e zhvillimit, kriteret e pranimit, planin dhe programet mësimore, rregullat e vlerësimit, rregullat e praktikës, rregullat e mbrojtjes së tezës, tarifën e shkollimit, si dhe krijon kushtet e përshtatshme për realizimin e programit.<br>Evidenca 6. Rregullore FTI.<br>Evidenca 7. Rregulloret PSP Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse. | Strukturat përgjegjëse dhe personeli akademik ndihmojnë studentët, duke vënë në dispozicion informacione, udhëzime dhe materialet e nevojshme në funksion të detyrimeve përmbyllëse.<br>Aspektet, kriteret, detyrimet, e cdo lënde, pedagogu përkatës ja paraqet studentëve në fillim të lëndës, në fillim të vitit akademik. Pedagogu i përcjell studentëve, udhëzime, dhe materialet e nevojshme për lëndën përkatëse.<br>Evidenca 5. Rregullore UAMD |
| **Kriteri 3.** Komisioni i posaçëm për administrimin e provimit përfundimtar bazohet në testimin e | Provimet dhe riprovimet, detyrat e kursit dhe prezantimet zhvillohen brenda afatit të caktuar në strukturën e vitit akademik. Datat e tyre shpallen që në fillim të vitit akademik. |

| | |
|---|---|
| njohuritë e dhëna gjatë gjithë vitit/viteve akademike, duke përfshirë të gjitha lëndët/ modulet në bazë të rëndësisë dhe peshës specifike. | Gjatë semestrave të rregullt mësimor lëndët e zhvilluara nga një pedagog vlerësohen vetëm prej tij, ndërsa gjatë sezonit të riprovimeve vlerësimi bëhet nga komisioni i ngritur nga departamenti që mbulon atë lëndë.<br>Evidenca 5. Rregullore UAMD. Neni 19 Zhvillimi i provimeve |
| **Kriteri 4.** Personeli akademik/ Udhëheqësi orienton dhe ndihmon studentët në përcaktimin e temave të punimit përmbyllës. Udhëheqësi i asiston studentin në nxjerrjen e rezultateve, përpunimin e tyre, si dhe shkrimin e punimit përmbyllës sipas udhëzuesve të miratuar. Ai garanton cilësinë e rezultateve dhe miraton ose jo nëse punimi është i plotë për t'u paraqitur para komisionit. | Në javën që i paraprin provimit, programi i lëndës parashikon orën e përsëritjes së programit mësimor të trajtuar gjatë zhvillimit të lëndës. Personeli akademik i lëndës udhëzon studentët në lidhje me provimin përfundimtar si dhe i përgjigjet pyetjeve të tyre në lidhje me paqartësitë që ata mund të kenë në lidhje me tematika të caktuara/<br>Në përfundim të studimeve të tyre, studentët diplomohen duke zhvilluar një provim të përgjithshëm përfundimtar diplomimi ose duke realizuar një projekt praktik i cili miratohet paraprakisht nga departamenti dhe mbrohet përpara një komisioni vlerësimi. Këto detyrime përmbyllëse mund të realizohen nga studenti vetëm kur ky i fundit ka shlyer të gjitha detyrimet e tjera akademike që përmban kurrikula e këtij programi studimi.<br>Evidenca 5. Rregullore UAMD |
| **Kriteri 5.** Institucioni ndihmon studentët për kryerjen e matjeve, analizave, testeve në mjediset e institucionit apo jashtë tij në bazë të temave të praktikave profesionale dhe fushës së studimit. | Qendra e karrierës, si njësi e ngritur pranë universitetit, inkurajon studentët të marrin informacione në lidhje me karrierën, ku stafi i përcjell studentëve për t'ju njohur me mundësitë e angazhimit me punë kërkimore.<br>karriera@uamd.edu.al.<br>Në institucion, studentët kanë mundësini e kërkimit studentor për të punuar dhe prodhuar punë kërkimore, që parë nga këndvështrimi studentor. Përmes ndërmjetësimit të Sektorit të Karrierës dhe Alumnit në UAMD, studentët punojnë për projektin e tyre kërkimor me mentorimin e anëtarëve të stafit akademik.<br>https://uamd.edu.al/studentet-dhe-kerkimi-shkencor/ |
| **Kriteri 6.** Në përfundim të detyrimit përmbyllës, studenti vlerësohet me notë. | Format dhe kriteret e vlerësimit të studentit janë të përcaktuara si në programin e lëndës, ashtu dhe në rregulloren e programit. Format dhe kriteret e vlerësimit i bëhen të ditura studentëve orën e parë të mësimit.<br>Sipas rregullores së programit, vlerësimi për secilën lëndë mësimore kryhet pas përfundimit të saj me sistemin e notave, ku 5 është nota minimale kaluese dhe 10 ajo maksimale. Në të gjitha format e provimit përdoret sistemi i vlerësimit me 1000 pikë, vlera përkatëse detyrimisht konvertohet në note.<br>Evidenca. 7. Neni 17/ Proçedura dhe kritere të vlerësimit |
| **Kriteri 7.** Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me "Çertifikatë profesionale" ose "Diplomë profesionale" në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin. Në përfundim të studimeve, studentit i vihet në dispozicion kopje e plotë zyrtare e programit të studimit të zhvilluar. | Studimet e programit 2 vjecar Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik përmbyllen me provim të përgjithshëm përfundimtar. Për të marrë pjesë në provimin e diplomës studenti duhet të ketë shlyer tëgjitha detyrimet e tjera të kurrikulës. Ai mund të regjistrohet vetëm pasi shlyerja e këtyre detyrimeve konfirmohet nga sekretaria mësimore e FTI.Procedura e organizimit dhe e vlerësimit të provimit të diplomës pasqyrohet në rregulloren e FTI.Në përfundim të studimeve, studenti pajiset me "Diplomë profesionale" në fushën e arsimimit të kryer, të miratuara nga ministria përgjegjëse për arsimin<br><br>https://uamd.edu.al/procedura-per-pajisjen-e-studenteve-me-program-studimi-2/ ,<br>Evidenca 5. Rregullore UAMD |
| **Kriteri 8.** Institucioni ruan në përputhje me legjislacionin në fuqi kopje të dokumentacionit të studentit dhe paraqet rast pas rasti informacione për studentin nëse kërkohen. | Kryen proçesin e regjistrimit të studentëve të rinj gjatë konkursit të pranimit si dhe proçedurën e regjistrimit të studentëve të pranuar. Plotëson kërkesat e studentëve për vërtetime të thjeshta, listë notash e dokumenta të tjera. Përgatit rregjistrat mësimorë dhe kujdeset për mirë administrimin e tyre. Përgatit proçesverbalet e vlerësimeve me emrat e studentëve dhe ia paraqet Komisionit për nënshkrim. Mirëadministron proçesverbalet e plotësuara të vlerësimeve. U jep informacion, studentëve në lidhje me vlerësimet vlerësimin,. Kryen hedhjen e notave në regjistrin themeltar sipas kurseve dhe lëndëve, përgatit diplomat dhe çertifikatat e notave për studentët që mbarojnë studimet. |

| | |
|---|---|
| | Evidenca 5. Rregullore UAMD Neni 13 Sekretaria mësimore;<br>Evidenca 1-Model-RVB-Diplome |
| **Konkluzione** | *FTI/UAMD ndjek një procedurë të qartë të detyrimeve përmbyllëse të studentit në programin e studimit dhe e pajis atë me dokumentacionin përkatës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | [redacted] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi III.6**<br>**Institucioni i arsimit të lartë ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton udhëzues në nivel institucional për zhvillimin dhe përdorimin e metodave të ndryshme dhe inovative të mësimdhënies në bazë të fushës së studimeve, lëndëve/moduleve. | Në bazë të statututit, rregullores, dhe planit strategjik, institucioni ka si qëllim dhe si mision e strategji zhvillimin e përdorimin e metodave të inovative në mësimdhënie. Kjo gjë përforcohet më tej, jo vetëm për vetë natyrës së këtij programi që është ngushtësisht i lidhur me ecurinë teknonologjike, por dhe dhe si rrjedhojë e paisjeve të punës laboratorike, përdorimit të programeve kompjuterike të rinovuara, ashtu sic i kërkon dhe ky program. Gërshetimi i teorisë me praktikën, stimulon zhvillimin e metodave të mësimdhënies, duke e bërë më ndërvepp ruese dhe më të kuptueshme për studentët.<br>Duke u bazuar në marrëveshjet dhe projektet Erasmus Plus31 dhe jo vetëm me partnerë evropianë personeli akademik i UAMD kryen trajnime dhe mësimdhënie të vazhdueshme në Universitete në vendet e BE duke e implementuar experiencën në mësimdhënie dhe duke e ndarë me kolegët nëpërmjet takimeve apo mbledhjeve të Njësisë Bazë.<br>Evidenca 5. Rregullore UAMD |
| **Kriteri 2.** Strukturat përgjegjëse zhvillojnë mekanizma të monitorimit dhe vlerësojnë në mënyrë periodike aftësitë mësimdhënëse dhe inovative të personelit akademik dhe ndihmës akademik. | NjBSC, si strukutë përgjegjëse brenda institucionit, krijon dhe zhvillon, e menaxhon zhvillimin e cilësisë, ku mblidhen evidencat dhe vlerësohet cilësia e shërbimit, në mënyrë që të analizohen nevojat dhe të vendosen synimet për zhvillimin e cilësisë. Sistemet e sigurimit të cilësisë kryhen nëprmjet :<br>proceseve të brendshme – Duke vënë në funksionim sisteme që ofrojnë performancë dhe i përgjigjen pyetjeve mbi saktësinë dhe efiçencën e procedurave të sigurimit të cilësisë.<br>Proçeseve të jashtme – Duke ju referuar qëllimit, vlerave dhe objektivave të institucionit, të cilat i referohen edhe dokumentave strategjikë kombëtarë dhe studimeve mbi kërkesat e tregut.<br>Evidenca17. Rregullore NJSBC.<br>Evidenca 18. Urdher per ngritjen e NjSBC |
| **Kriteri 3.** Strukturat përgjegjëse për monitorimin dhe sigurimin e cilësisë në mësimdhënie bëjnë publike rezultatet e vlerësimit. | NjBSC, si strukturë përgjegjëse brenda institucionit, monitoron dhe siguron cilësinë në mësimdhënie, dhe rezultatet bëhen publike.<br><br>Evidenca 18. Urdhër ngritjeje NJSBC |
| **Kriteri 4.** Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit dhe rezultateve të marra, promovon shembuj të praktikave të mira, nxit personelin akademik për përmirësimin e mëtejshëm të mësimdhënies. | Institucioni, nëpërmjet mekanizmave të vlerësimit, sistemit, koordinimit te punës dhe njësive përkatëse, arrin të nxisë dhe promovojë punën e stafik akademik, nëpërmjet konferencave, botimeve dhe bashkëpunimeve shumëplanëshe që institucioni ka ndërtuar. Këto aspekte përmbushen në sajë të angazhimit të institucionit, strategjisë së tij për cilësinë akademike, nëpërmjet bashkëpunimeve të shumta institucionale dhe mobilitetit akademik.<br>Duke u bazuar në marrëveshjet dhe projektet Erasmus Plus31 dhe jo vetëm me partnerë evropianë personeli akademik i UAMD kryen trajnime dhe mësimdhënie të vazhdueshme në Universitete në vendet e BE duke e implementuar experiencën në mësimdhënie dhe duke e ndarë me kolegët |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| | nëpërmjet takimeve apo mbledhjeve të Njësisë Bazë. | | | |
| **Konkluzione** | *FTI/UAMD ndjek një politikë të qartë për garantimin dhe promovimin e cilësisë së mësimdhënies dhe harton udhëzues të posaçëm të zhvillimit të metodave dhe monitorimit.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | [redacted] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës III** | [redacted] | [redacted] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

# IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

| **Standardi IV.1**<br>**Personeli akademik dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet sasiore dhe ka kualifikimin e duhur e të posaçëm akademik dhe profesional në përputhje me fushën e programit, për garantimin e standardeve të mësimdhënies të programit të studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Personeli akademik dhe ndihmës akademik, që angazhohet në realizimin e programit të studimit, përmbushin kërkesat ligjore në fuqi, për nivelin e kualifikimit akademik, për drejtimin e programit, drejtimin dhe angazhimin në mbulimin e lëndëve/moduleve të programit, për fushën kërkimore ose eksperiencën praktike në përputhje me programin e studimit, natyrën dhe veçorinë e moduleve të tij. | Gjatë takimeve që në institucion me Zyrën e Burimeve Njerëzorem GVJ konstatoi se kjo zyrë administron dosjet që përmbajnë dokumentacionin e nevojshëm të personelit efektiv dhe atij me kontratë duke i përditësuar ato vazhdimisht. GVJ zgjodhi në mënyrë të rastësishmë dosje të pedagogëvë të brendëshëm dhe të jashtëm, nga ku konsaton se personeli akademik me kohë të plotë dhe kohë të pjesshme, që angazhohet në realizimin e programit të studimit "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik" përmbush kërkesat ligjore në fuqi. Kjo zyrë në pëmbajtje të çdo dosje për personilin ruante informacioni: formularin e aplikimit, fotokopje të noteriazuara të diplomave dhe çertifikatave të notave, fotokopje të noterizuar të titujve dhe kualifikimeve të ndryshme, tre letra rekomnadimi, artikuj shkencor, librezë pune, raport mjekësor i aftësisë ne punë, dëshmi penaliteti, urdhër emërimi dhe kontratën.<br><br>Departamentin i Shkencave Kompjuterike përgjegjës për programin Profesional 2-vjeçar "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik", ka 30 anëtar në staf, nga të cilët:<br>• 16 janë Personel Akademik Efektiv,<br>• 10 janë Personel Akademik me Kontratë dhe<br>• 4 janë Personel Akademik Ndihmës.<br>PAE janë: 4 Dr, 9 Dr. (proc.) dhe 3 MSc.<br><br>PAK janë: 1 Prof.Dr., 2 Prof. As. Dr. dhe 2 Dr. dhe 5 MSc.<br><br>Evidenca: CV – AWDG;<br>Tabelat përmbledhëse Tabela 1, Tabela 2 dhe Tabela 6 |
| **Kriteri 2.** Personeli akademik efektiv | Nga dokumentacionet e dorëzuara, përkatësisht Tabela 12, Plani |

| | |
|---|---|
| duhet të mbulojë ngarkesën mësimore për programin e studimit në përputhje me kornizën ligjore në fuqi. | mësimor i lishur me personelin akademik përkatës, vihet re sa janë të pasqyruar lëndët e mbuluar nga personeli akademik efektiv. Sipas tabelave 85 % është e e mbulluar nga staf PAE i Universitetit Aleksandër Moisiu ku përveç Fakultetit të Teknologjisë së Inofmracionit ka edhe PAE nga departamente të tjera si ai i Drejtësisë dhe Juridikut<br><br>Evidenca: Tabelat përmbledhëse Tabela 12 |
| **Kriteri 3.** Institucioni duhet të garantojë dhe të dëshmojë qëndrueshmërinë e personelit akademik të angazhuar në programin e studimit, për të gjithë periudhën e akreditimit, duke përfshirë kontratat e punësimit dhe mbulimin me sigurime shoqërore dhe shëndetësore. | Personeli i angazhuar në mësimdhënie sipas viteve akademike është:<br><br>Viti akademik 2022-2023: 14 PAE dhe 3 PAK.<br><br>Viti akademik 2021-2022: 11 PAE dhe 4 PAK.<br><br>Viti akademik 2020-2021: 10 PAE dhe 2 PAK.<br><br>Gjithashtu nga takimi me Zyrën e Burimeve Njerëzore GVJ konstatoi se personeli akademik si ai efektiv ashtu edhe ai i jashtëm apo administrativ, ka kontrata të rregullta pune. Në këto kontrata janë gjithashtu të gjithë deklarimet e sigurimeve shoqërore e shëndetësore sipas legjislacionit në fuqi. Personeli akademik me kontrat i punësuar në vitin e mëparshëm për t'u riaktivizuar mjafton të depozitojë kërkesën, pa i risjell të gjitha dokumentat.<br><br>Evidenca: Tabelat përmbledhëse Tabela 6;<br>Takimet me Zyrën e Burimeve Njerëzore |
| **Kriteri 4.** Institucioni ndjek procedura rekrutimi dhe vlerësimi, mbështetur në kritere të përgjithshme dhe specifike të shpallura dhe që garantojnë përzgjedhjen e personelit me nivelin e duhur të kualifikimit dhe në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. | Universiteti "Alekasandër Mosiu" Durrës (UAMD) ndjek me përpikmëri bazën ligjore për rekrutimin e personelit në përputhje me Ligjin për Arsimin e Lartë, VKM për stafet akademike, Kodi i Punës, aktet nënligjore të MAS. Zyra e Burimeve Njerëzore është përgjegjëse për zbatimin e procedurave të rekturimit të personelit. GVJ verifikoi se kuadri rregullativ i UAMD përmban procedura transparente të rekrutimit dhe te vlerësimit të personelit. Kjo mënyrë siguron që kandidatëtët të plotësojnë kushtet dhe të jenë në nivelin e duhur të kualifikimeve në përputhje me natyrën, strukturën, modulet dhe përmbajtjen e programit të studimit. Gjithashtu kritere e përcaktuara në dokumentin e politikës së rekrutimit, rekrutojnë personel me arritje të larta akademike, me tituj dhe grada shkencore. Kriteret për rekrutiminm e tyre lidhen me aftësitë akademike të fushës përkatëse ku do të shërbejë.<br><br>Evidenca nr. 5: Rregullorja IAL UAMD;<br>Takimi në institucion me Zyrën e Burimeve Njerëzore dhe stafin akademik |
| **Kriteri 5.** Institucioni siguron dhe garanton angazhimin e personelit ndihmës akademik të përshtatshëm dhe të mjaftueshëm për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve të tjera mësimore, sipas natyrës specifike të programit të studimit. | GVJ vizitoi ambjentet dhe laboratorët. Për vetë natyrën e programit të studimit profesional 2-vjeçar "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik", një pjesë e mirë e lëndëve zhvillohen në laboratorët si praktikë për lëndën. FTI ka në strukturën e tij 10 punonjës si personel ndihmës akademik të cilët janë laborant dhe sekretare të programeve të studimit. Përkatësishtë në DSHK ka në strukturën e tij 2 personel laborant që merret me mirëmbajtjen dhe menaxhimin e infrastrukture së laboratoreve që janë në funksion të këtij programi studimi. Janë gjashtë laboratore të FTI.<br><br>Vizita e GVJ në institucion; Mjediset e Fakultetit/Njesive baze, Tabela 1, Tabelat 2, Tabela 16 |
| **Kriteri 6.** Institucioni mbledh, ruan dhe përditëson çdo vit akademik të dhënat e personelit të angazhuar në programin e studimit. Këto të dhëna përfshijnë anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe | GVJ zgjodhi në mënyrë të rastësishmë dosje të pedagogëve të brendëshëm dhe të jashtëm, nga ku konsaton se Zyra e Burimeve Njerëzore e UAMD ka dosjet me dokumentat përkatëse për të gjithë personelin, ku për çdo pedagog të programit disponon të dhënat e kualifikimeve të tij/ të saj, kontratat e punës, dokumente që lidhen me vjetërsinë në punë, të dhëna për zhvillimin e |

| | |
|---|---|
| të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit, angazhimin e çdo anëtari në çdo semestër dhe vit akademik, si dhe atë të personelit ndihmësakademik dhe administrativ. | vijueshëm profesional.<br><br>Çdo vit akademik përditësohen CV e pedagogëve, ku pasqyrohen veprimtaritë kërkimore, publikimet dhe konferencat shkencore ku ai/ajo merr pjesë. Departamenti dhe NJSBC disponon ngarkesën mësimore të secilit pedagog/e për secilin semestër, si dhe oraret mësimore për pedagogët, bashkë me programet lëndore ku pedagogu/ja është titullar/e apo lektor/e e lëndës. Po ashtu, çdo fillim viti dhe semstri përcaktohet ngarkesa mësimore për personelin akademik, ndihmës akademik dhe administrative.<br><br>Vizita e GVJ në institucion |
| **Kriteri 7.** Institucioni, në marrëveshje dhe bashkëpunim me institucione të tjera të arsimit të lartë, përfaqësues biznesi e kompani, vë në dispozicion personelin e mjaftueshëm, të duhur e të kualifikuar për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale, dhe veprimtari të tjera specifike sipas natyrës së programit të studimit. | UAMD ka lidhur një sërë marrëveshjesh bashkëpunimi në rang universiteti. Janë 36 marrëveshje me universitete kombëatrë/ndërkombëtare institucione ose kompani.<br><br>Studentët nuk kanë lëndë si praktikë profesional por për shumë nga lëndët e formimit profesional ata zhvillojnë praktika të tyre në laboratoret e FTI. Një pjesë e stafit të jashtëm janë specialist nga kompanit me të cilat FTI bashkëpunon si Crystal System.<br><br>Evidenca nr. 28 Laboratore FTI, Tabelat përmbledhëse Tabela 2, Tabela 5 |
| **Kriter 8.** Personeli mbikqyrës në ambientin pritës që angazhohet në realizimin e praktikave profesionale në bazë të marrëveshjeve, duhet të ndihmojë studentët në përmbushjen e detyrimeve /raportin përfundimtar të praktikës si dhe të marrë pjesë në procesin e vlerësimit të tyre për praktikën profesionale. | Nuk aplikohet, programi i studimit nuk ka lëndë Praktikë profesionale.<br><br>Evidenca nr. 9 Plani Mesimor |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se në Departamentin e Shkencave Kompjuterike (DSHK), personeli akademik efektiv dhe ndihmës akademik që mbulon programin e studimit, përmbush standardet në përputhje me fushën e programit, si të mësimdhënies të programit të studimit. Rekondon shtimin edhe si lëndë të Praktikës Porfesionale.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | Përmbushet [illegible] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| | |
|---|---|
| **Standardi IV.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion mjedise mësimore dhe infrastrukturën e përshtatshme për realizimin e procesit mësimdhënës të programit të studimit dhe për formimin praktik, të posaçme sipas natyrës dhe fushës së programit të studimit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni siguron mjediset e mjaftueshme dhe të | GVJ vizitoi ambjentet e FTI ku zhvillohet ky program studimi. Hapësirat janë të ndara në 7 klasa leksioni/seminari, 10 laboratorë, 1 salle aktivitete |

| | |
|---|---|
| përshtatshme për zhvillimin e veprimtarisë mësimore, në varësi të numrit të studentëve, grupeve mësimore, në përputhje me natyrën specifike të programit të studimit dhe moduleve përkatëse. | promovuese dhe 1 sallë për praktikë lëndore/profesionale si dhe zyra për stafin.<br><br>Institucioni ka 1 sallë bibliotekën dhe 1 zyrë informacioni për studentë.<br><br>Tabelat përmbledhëse: Mjediset e Fakultetit/Njësive Bazë (Tabela 16) |
| **Kriteri 2.** Mjediset mësimore si klasa, laboratorë, studio e mjedise të tjera, janë të pajisura me mjete elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, që garantojnë realizimin e procesit mësimor teorik e praktik, përmes përdorimit të metodologjive e teknologjive bashkëkohore të mësimdhënies-mësimnxënies. | GVJ nga vizita në institucion konstaton se çdo klasë laboartori ku zhvillohen shumica e lëndëve të këtij programi studimi ka kompjuter dhe videoprojektor funksional dhe akses të përhershëm interneti.<br><br>Sallat kanë hapësirën e nevojshme për të ushtruar mësimdhënien në kushte të mira dhe komode për studentët. Secili mjedis disponon ajrosjen dhe ndriçimin e duhur, sistem mbrojtje nga zjarri edhe ajër të kondicionuar. Ambjentet janë të pajisura me banka dhe karrige komode për t`ju përgjigjur edhe qëndrimit me orë të zgjatura në leksione dhe seminare të studentëve.<br><br>Vizita GVJ në institucion |
| **Kriteri 3.** Laboratorët, studiot, atelietë, bazat e praktikës profesionale apo mjediset e tjera, sipas natyrës specifike të programit, përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme e të përshtatshme për plotësimin e kërkesave të moduleve, aftësimit teorik e praktik dhe të objektivave formues të programit të studimit në tërësi. | FTI për lëndët dhe programet e Informatikës ka infrastrukturë të përshtatshme teknologjike me 6 laboratorë kompjuterash dhe pajisjesh multimediale bashkëkohore. Të gjithë kompjuterat janë arkitekturë ëorkstation me parametra të lartë teknikë, dhe programe të nevojshme për lëndët.<br><br>Nga sa më sipër laboratorët mundësojnë aplikimin në praktikë të njohurive teorike.<br><br>Evidenca nr. 28 Laboratore FTI;<br>Vizita GVJ në institucion |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë siguron së paku një laborator të teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale sipas natyrës së programit të studimit që ofron. | GVJ vizitoi 5 laboratorët informatikës dhe 1 të multimedias dhe pohon se ato përmbushin nevojat e programit të studimit profesional 2-vjeçar "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik".<br><br>Vizita GVJ në institucion |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se në FTI, infrastruktura përmbush nevojat e programit të studimit profesional* "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik", *për realizimin e procesit mësimdhënës dhe të formimit praktik të studentëve.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.3**<br><br>**Programi i studimit duhet të përmbajë literaturën e nevojshme dhe të përditësuar në mbështetje të mësimdhënies dhe mjediset mbështetëse të mësimnxënies (bibliotekën, mjedise të posaçme).** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Literatura bazë dhe ndihmëse e vënë në dispozicion të studentëve në gjuhën e programit të | Një pjesë e konsiderueshme e literaturës bazë dhe ndihmëse, në format fizik dhe digjital, ndodhet në bibliotekën e UAMD, Currila, në hapësirën e dedikuar fushës së teknologjisë së informacionit në mënyrë që studentët të |

| | |
|---|---|
| studimit (fizike dhe digjitale) garanton marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit. | mund të kenë akses të menjëhershëm sipas nevojave.<br><br>Evidenca nr. 22 Biblioteka online;<br>Tabelat përmbledhëse Të dhëna për platformat online/ Biblioteka (Tabela 17);<br>Vizita në biblioteke |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën mësimore, duke garantuar mundësinë e shfrytëzimit në mënyrë të barabartë nga studentët e programit të studimit. | Biblioteka e UAMD, në degën e Currilave, është e konceptuar dhe e implementuar në hapësirë me poste leximi dhe 10 kompjutera në dispozicion. Në biblotkë gjenden 12000 tituj në gjuhë shqipe dhe të huaj.<br><br>GVJ-s j'u vu në dispozicion Sistemi "KOHA" që ofron kërkimin automatik të çdo artikulli. Bibloteka është e abonuar ne revista shkencore on-line si Koha, Cobiss, U-LIBRAY, Jstore që lejon aksesimin e informacioneve të pasura dhe bashkëkohore.<br><br>Evidenva nr. 22 Biblioteka online;<br>Tabelat Permbledhese Tabela 17;<br>Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibloteké |
| **Kriteri 3.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe e përshtatshme për mbulimin e të gjitha moduleve e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. | Biblioteka e UAMD është e pajisur me fond fizik, si: tekste mësimore bazë, literaturë ndihmëse, e mjaftueshme në gjuhën shqipe dhe të huaja, libra apo revista shkencore të nevojshme, të mjaftueshme dhe të përshtatshme.<br><br>Ne vërejmë se Bibloteka mbulon të gjitha modulet e veprimtarive mësimore sipas natyrës e specifikës së programit të studimit. Në bibliotekë studentët mund të gjejnë në format fizik dhe elektronik edhe leksionet e çdo lëndë nga pedagogët përkatës.<br><br>Biblioteka është në dispozicion të studentëve, për të gjithë kohëzgjatjen e orarit zyrtar të punës së institucionit.<br><br>Evidenva nr. 22 Rregullorja e bibliotekës;<br>Vizita GVJ në institucion-Takim në Biblotekës |
| **Kriteri 4.** Institucioni duhet të krijojë kushte për shfrytëzim të barabartë e pa pagesë për studentët në bibliotekat online të fushës së programit të studimit. | GVJ në vizitën e tij në Bibloteké, konsaton se studentët dhe pedagogët kanë akses të barabartë e pa pagesë në bibliotekën digjitale online, që siguron qasje në revista akademike, libra dhe burime kryesore. Cdo student e pedagog ka të drejtë anëtarësimi falas në bibliotekë.<br><br>Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibloteké |
| **Kriteri 5.** Biblioteka duhet të jetë e pajisur me programe kompjuterike dhe pajisje të tjera teknike, që mundësojnë shfrytëzimin pa kufizim për të gjithë studentëve. | GVJ konsaton se Biblioteka është e pajisur me poste leximi dhe pajisje kompjuterike, për ofrimin dhe aksesimin në bibliotekën digjitale të universitetit dhe të bibliotekave online ndërkombëtare duke përmbushur nevojat e studentëve.<br><br>Vizita GVJ në institucion-Takim në Bibloteké |
| **Kriteri 6.** Biblioteka duhet të vihet në dispozicion të studentëve në orare shërbimi që janë në përshtatje me oraret e zhvillimit të procesit mësimor dhe përtej tyre, në përgjigje edhe të nevojave, numrit të studentëve dhe kapacitetit të saj. | Biblioteka në UAMD është në dispozicion të studentëve, për të gjithë kohëzgjatjen e orarit zyrtar të punës së institucionit.<br><br>Orari i hapjes dhe mbylljes së bibliotekës është 08.00 – 16.00.<br><br>Menaxhimi i librave të bibliotekës bëhet në përputhje me rregulloren e biblitekës.<br><br>Evidenva nr. 22 Rregullorja e bibliotekës;<br>Vizita GVJ në institucion-Takim në Biblioteké |
| **Kriteri 7.** Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit ndjekin dhe raportojnë për cilësinë e fondit fizik të bibliotekës dhe fondit online (titujt kryesorë të pranishëm në shërbim të | Nga takimet, vizitat, që GVJ zhvilloi në institucion, vërehet një fryme bashkupunimi mes departamenteve e bibliotekës për rritjen e cilësisë së shërbimit të bibliotekës. Lektorët e lëndëve të programit të studimit depozitojnë gjithmonë në biblotekë një kopje të materialeve të leksioneve, nëse nuk ka libra si fond fizik. Studentët dhe personeli akademik kanë akses |

| | |
|---|---|
| programit), përditësimin, shkallën e shfrytëzimit të fondit fizik dhe fondit online nga personeli akademik dhe studentët e programit, shfrytëzimi i sallave të studimit, duke nxjerrë në pah sa të efektshme kanë qenë përpjekjet për pasurimin fondit fizik dhe atij online, cilat janë kërkesat për tituj. | në të gjitha fondet online.<br><br>Evidenva nr. 22 Rregullorja e bibliotekes |
| **Konkluzione** | *Biblioteka dhe njësitë përgjegjëse të programit garantojnë literaturë të mjaftueshme (fizike dhe digjitale) për marrjen e dijeve dhe njohurive të nevojshme, të parashikuara në programin e studimit si dhe mjedise të përshtatëshme për shfrytëzimin e kësaj literature.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.4**<br>**Institucioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon sistem të menaxhimit nëpërmjet të cilit administron të gjithë informacionin që lidhet me studentët dhe aktivitetin e tyre, nga regjistrimi deri në diplomimin e tyre në programin e studimit. | Institucioni disponon sisteme të menaxhimit të studentëve. Sistemet i integruara i informacionit (Pitagora) është në bashkëpunim me projektin e RASH (Rrjeti Akademik Shqiptar linku: https://www.rash.al/sq/). Me anë të këtij sistemi realizohet menaxhimi i karrierës së studentëve si: hyrjen (regjistrimin e tyre në programe studimi) dhe lëvizjet (transferimet e tyre), faturimet, pagesat, menaxhimin e mësimdhënies, klasat, transkriptet e notave. Të gjitha këto realizohen duke vënë në dispozicion të studentëve dhe të personelit akademik salla dhe laboratorë informatike.<br><br>UAMD ju siguron informacion studentëve edhe në zyrat e sekretateve përkatëse të programit të studimit.<br><br>[https://uamd.edu.al/pitagora/] |
| **Kriteri 2.** Sistemi i brendshëm i menaxhimit administron informacionin, dokumentacionin dhe aktivitetin e personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. | FTI/UAMD e administron informacionin dhe dokumentacionin e tyre që lidhet me zhvillimin dhe mbarëvajtjen e procesit mësimor nëpëmjet sistemit Pitagora dhe zyrës së Burimeve Njerëzore.<br><br>Në Zyrën e Burimeve Njerëzore ruhen dhe administrohen informacione për personelit akademik, personelit ndihmësakademik, personelit administrativ dhe partnerëve të angazhuar në realizimin e programit. Personeli akdemik joefektiv nëse ka qenë i angazhuar një vit më pare në UAMD nuk është e nevojshme të sjelli gjithë dokumentcionin e aplikimit, por vetëm kërkesëne, vërtetim page dhe vërtetime nëse ka pasur ndryshime në titujt akademik.<br><br>Në systemin Pitagora ruhet informacion i personelit akademik të angazhuar në realizimin e programit të studimit për çdo vit akademik. |

| | |
|---|---|
| | Vizita GVJ në institucion-Takimi me Burimet Njerëzore |
| **Kriteri 3.** Sistemi i menaxhimit siguron akses të dedikuar në informacione e dokumente për të gjithë personelin dhe studentët e programit të studimit. | Sistemi Pitagora ka askes të dedikuar të inofmacionit për profilet e ndryshme të përodruesve: Personeli akedemik, personeli ndihmësakademik (Sekretaret), zyrën e financës dhe studentët. Të gjitha këto kategori përdoruesish logohen në sistem me kredencialet e tyre: username dhe passëord. Infomacioni për çdo kategori është sipas të drejtave të informacionit që ato mund të aksesojnë.<br><br>Vizita GVJ në institucion; https://www.ubt.pitagora.rash.al/; https://uamd.edu.al/pitagora/ |
| **Kriteri 4.** Sistemi i menaxhimit ka të integruar platforma dhe module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit ndërmjet personelit dhe studentëve. | Sipas profileve të personelit dhe studentëve, sistemi i menaxhimit siguron module që mundësojnë forma të komunikimit interaktiv dhe shkëmbimit të informacionit. Personeli ka informacion për studentët sipas profileve dhe degëve të studmimt, për çdo modul ku është i aktizizuar. Në përfundim të zhvillimit të modulit ruan rezultatet e secilit student dhe ky informacion i komunikohet çdo student në profilet përkatëse.<br><br>Vizita GVJ në institucion-Takimet me personelin dhe studnetët; https://www.ubt.pitagora.rash.al/ |
| **Kriteri 5.** Sistemi i menaxhimit garanton monitorim në kohë reale të aktivitetit akademik e administrativ dhe mundëson raportime individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese. | Sistemi Pitagora monitoron në kohë reale të aktivitetit akademik e administrative si ruajtja e pagesave nga zyra financiare për stuentët dhe raportimin individuale dhe të dhëna në kohë reale për organet dhe autoritetet drejtuese të FIT/UAMD.<br><br>Vizita GVJ në institucion;<br>RVB Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik |
| **Kriteri 6.** Informacionet që lidhen me programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme, publikohen në faqen zyrtare të internetit të njësisë përgjegjëse për programin e studimit. | Në faqen zyrtare të internetit të FTI gjendet informacion për programin e studimit, personelin akademik, aktivitetet e ndryshme.<br><br>https://uamd.edu.al/aplikacion-Web-dizenjim-grafik/; https://uamd.edu.al/ëp-content/uploads/2022/11/AWDG.pdf |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se UAMD disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit. Rekomandon që në faqen e internetit të stohet dhe informacion për personelin akademik të angazhuar në mësimdhënie në programin e studimit Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi IV.5**<br><br>**Instituсioni i arsimit të lartë disponon një sistem të brendshëm të menaxhimit institucional dhe e vë atë në dispozicion të administrimit, informimit dhe monitorimit të aktivitetit akademik, financiar e administrativ për programin e studimit me karakter profesional.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton një raport financiar të kostove të njësisë | UAMD si institucion i arsimit të Lartë gëzon liri akademike, autonomi finaciare, organizateve në përputhje me legjistalacionin në fuqi. Bordi |

| | |
|---|---|
| bazë përgjegjëse për programin e studimit dhe planin për mbështetjen financiare të nevojshme për mbarëvajtjen e programeve të studimit për të paktën një cikël të plotë studimi. | Administarativ është organi më i lartë kolegjial administarativ në UAMD. Ky bord përcakton rregullat për shpërndarjen e të ardhurave që siguron universiteti nga vepritaria e tij dhe mbikqyr përdorimin e të ardhurave financiare.<br>Evidenca nr 2. STATUTI-MIRATUAR-UAMD, Neni 5, Neni 32 dhe Neni 34 |
| **Kriteri 2.** Plani i financimit të njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit duhet të përmbajë financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë. | GVJ konstaton se në palnin e financimit të UAMD janë të pasqyruara financimet për burimet njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve dhe teknologjive mbështetëse të procesit mësimor, shpenzimet për bibliotekën dhe pasurimin e literaturës e aksesin në bibliotekat online, detyrimet financiare, grantet vendase apo të huaja të përfituara dhe kontratat e shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimit, projektet dhe zëra të tjerë.<br>https://uamd.edu.al/wp-content/uploads/2023/03/Raportimi-i-muajit-Dhjetor-2022-TAB.pdf |
| **Kriteri 3.** Institucioni kryen auditim periodik, vlerëson dhe dokumenton gjendjen e financimit dhe efektivitetin financiar të tij. | Në pasqyrat finaciare të raportuara në Web UAMD jep informacion për financimin e burimeve njerëzore në shërbim të realizimit të programeve, shpenzimet operative për mirëmbajtjen e mjediseve. Ky informacion është i pasqyruar për muajt Dhjetor 2022, Janar 2023 dhe Shkurt 2023.<br>GVJ rekomandon që të dhënat fianciare të jenë trasparente dhe për periudhat e mëparshme dhe ato në vazhdimësi.<br>[Evidenca nr 2. STATUTI-MIRATUAR-UAMD, Neni 5, Neni 32 dhe Neni 34; https://uamd.edu.al/infomacion-mbi-buxhetin/] |
| **Kriteri 4.** Institucioni të raportojë deri në nivelin e njësisë bazë përgjegjëse për programin e studimit mbi realizimin e buxhetit të miratuar të vitit paraardhës. | Informacioni i pasqyruar është në nivel Universiteti duhet të pasyrohet edhe në nivel njësie bazë.<br>[https://uamd.edu.al/infomacion-mbi-buxhetin/] |
| **Kriteri 5.** Institucioni garanton qëndrueshmërinë financiare për zhvillimin e programeve të studimit të njësisë bazë dhe kapacitetet financiare të mjaftueshme për ecurinë normale të këtyre programeve. Në rastet e nevojave të përmirësimit të situatës financiare institucioni planifikon ndërhyrje të posaçme dhe diversifikimin eventual të financimit të programeve të studimeve. | GVJ konstaton se nga të dhëant e tabelës përmbledhëse për të ardhurat dhe finacimet për tre vitet e fundit, institucioni garanton qëndrueshmëri financiare për zhvillimin e vepritarisë së tij akademike dhe ecurinë normale të programeve të studimit.<br>Sipas viteve këto të ardhura janë:<br>• Viti 2020 – Shuma totale 1 082 354 067<br>• Viti 2021 – Shuma totale 1 076 144 918<br>• Viti 2022 – Shuma totale 1 133 710 586<br>Tabela Permbledhese Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik, Tabela 18; Evidenca nr 2. STATUTI-MIRATUAR-UAMD, Neni 5, Neni 32 dhe Neni 34; https://uamd.edu.al/infomacion-mbi-buxhetin/ |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se institucioni ka qëndrueshmëri finaciare.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | [redacted] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | X | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës IV** | [redacted] | [redacted] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | X |

## V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE

| **Standardi V.1**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni harton dhe zbaton politika dhe procedura që mbulojnë ciklin e plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore. | UAMD bazohet në legjislacionin në fuqi dhe aktet e veta rregullatore për procedurat e financimit të ciklit të plotë akademik të studentëve nga hyrja në dalje, përkatësisht Ligj Nr. 80/2015 Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë, neni 109 dh 110. Gjitahshtu në rregulloren e programit të studimit janë të specifikuara në detaje politikat e prienimit.<br><br>Evidenca nr. 7. Rregullore e programit te studimit AWDG, neni 23; 14. Ligj_80-2015_22.07.2015 per arsimin e larte, neni 109 dhe 110 |
| **Kriteri 2.** Politikat dhe procedurat nga hyrja në dalje garantojnë barazinë dhe të drejta të njëjta për të gjithë kandidatët për studentë dhe studentët e programit të studimit. | Përzgjedhja e kandidatëve bazohet në parimet e barazisë, të drejtësisë, të paanësisë dhe të meritës është një nga pikat e politikave të pranimit të sudentëve në këtë program studimi.<br><br>Evidenca nr. 7. Rregullore e programit te studimit AWDG, neni 23 |
| **Kriteri 3.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere për përzgjedhjen e kandidatëve për t'u pranuar në programin e studimeve. Institucioni bashkëpunon me strukturat e ngritura në zbatim të maturës shtetërore, sipas ligjit dhe udhëzimeve përkatëse. | Departamenti i Shkencave Kompjuterike propozonë kriteret e pranimit për programin e studimit profesional 2-vjeçar "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik" si dhekriteret që do përdoren për përzgjedhjen e kandidatëve fitues. Kriteteret e propozuara nga departamentet miratohen nga Dekanati dhe i dërgohet për miratimin përfundimtar Senatit Akademik të UAMD-së. Këto informacione bëhen publike në faqen e internet de ato të rrjeteve sociale të fakultetit.<br><br>Evidenca nr. 6. Rregullore FTI, neni 29;<br>7. Rregullore e programit te studimit AWDG, neni 23; https://www.facebook.com/FTIUAMD;<br>https://uamd.edu.al/ëp-content/uploads/2023/03/KRITERET-UAMD-2023-2024.pdf |
| **Kriteri 4.** Kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së | Rregulloret e institucionit, njësisë kryesore dhe programit të studimit kanë informacion të plotë për kriteret, procedurat e pranimit dhe përzgjedhjes së studentëve, përparimit përgjatë kursit të studimit, të transferimit, njohjes së kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit. Këto |

| | |
|---|---|
| kurseve profesionale të kryera, të vlerësimit të dijeve dhe të diplomimit janë lehtësisht të kuptueshme dhe të aksesueshme nga publiku. | informacione stuentët mund ti gjejnë në zyrat përkatëse në institucion, faqen zyrtare të UAMD dhe në rrejtet sociale të FTI/UAMD.<br><br>Evidenca nr. 5. Rregullore IAL UAMD;<br>6. Rregullore FTI, neni 29;<br>7. Rregullore e programit te studimit AWDG, neni 23; 24.<br>Vendim Nr.6 për kriteret dhe kuotat 2022-2023. |
| **Kriteri 5.** Institucioni harton dhe publikon përpara çdo viti akademik kritere të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve me aftësi të veçanta, të pakicave dhe shtresave të margjinalizuara. | Kriteret e pranimit janë të publikuara edhe në faqen zyrtare të universitetit për cdo degë.<br><br>https://uamd.edu.al/kriteret-e-pranimit/ |
| **Kriteri 6.** Institucioni harton politika të ndihmës/bursave për shtresa në nevojë dhe për të rritur cilësinë e pranimit në programe me përparësi për institucionin dhe për zhvillimin ekonomik të vendit. | Në faqen e internetit ka një rubrik për Bursat e studnetëve por nuk ka informacion në të. |
| **Konkluzione** | *GVJ konaaton se UAMD harton, ndjek dhe zbaton politika dhe procedura për pranimin, përzgjedhjen, përparimin e studentëve, transferimin, njohjen, vlerësimin e dijeve dhe diplomimin në programin e studimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.2**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit në atë program.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni vë në dispozicion informacion të plotë dhe të hollësishëm në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin. | Në UAMD kanë disa mënyra për të marrë informacion të plotë në lidhje me kriteret e procedurat e përparimit akademik të studentëve dhe kalimit nga një vit akademik në tjetrin, ato janë:<br>• Faqia zyrtare e internetit;<br>• Sekretaria mësimore e cila ju jep informacion të detajuar studentëve për lëndët, kreditet, kalimin në vitin e dytë të studimeve;<br>• Përgjegjsia e Deprtametit dhe koordinatorit të programit të studimit në fillim të vitit akademik bëjnë javën e orientimit të studentët për informimin e tyre për programin mësimor, ambjentet, detyrimet dhe të drejtat e studentëve.<br><br>Evidenca Faqe Web: https://uamd.edu.al/aplikacion-Web-dizenjim-grafik/;<br>Dok RVB Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik |
| **Kriteri 2.** Institucioni informon | Studentët të cilët kanë kryer më parë studime të pjeshmë informohen për |

| | |
|---|---|
| studentët në lidhje me kriteret e procedurat e njohjeve të kualifikimeve të mëparshme nga kurse profesionale të kryera ose studimeve të pjesshme. | kriterte dhe njojen e tyre të mundshme nga përgjegjësia e Departamentit ose zyrat përkatëse në institucion. |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit. | Përgjegjësia e Departamentit në javën e parë të indormimit të studentëve dhe pedagogët e lëndëve në ditën e parë të mësimit për lëndët që mbulojnë i informojnë studentët në lidhje me kriteret e procedurat e vlerësimit të dijeve e aftësive të studentëve në programin e studimit.<br><br>Dok RVB Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik |
| **Kriteri 4.** Institucioni i arsimit të lartë informon studentët në lidhje me kriteret e procedurat e punimit përfundimtar dhe diplomimit në programin e studimit. | Studentët e programit të studimit profesionale 2-vjecarë "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik" në përmbyllje të studimeve të tyre duhet të mbrojnë provimin e formimit ose punimin e diplomës. Këtë informacion studentët e marrin që në momentin e regjistrimit dhe njohjen me programin e lënvëve por edhe në vitin e dytë kur duhet të fillojnë të përgatiten. Studentët të cilët do të zhvillojnë punim diplome duhet të dorëzojnë praprakisht në department Tezën e Diplomës e cila përmbanë: Kërkesën e studentit, tëmën e propozuar dhe firmat e studentit dhe udhëheqësit të temës.<br><br>Evidenca nr 7. Rregullore e programit te studimit AWDG, neni 16,<br>Faqe Web: https://uamd.edu.al/aplikacion-Web-dizenjim-grafik/ |
| **Kriteri 5.** Përpara fillimit të çdo viti akademik dhe në mënyrë periodike, institucioni i arsimit të lartë publikon udhëzues të posaçëm dhe organizon takime të hapura për informimin e të interesuarve e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit | UMAD me urhdër të Rektorit çdo muaj Mars ka ngritur grupet e punës për promovimin dhe informimin e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Kjo është kryer deri në vitin 2022. Ndërsa këtë vit dhe sipas udhëzimeve të ministrisë ky promovim është realizuar në ambjentet e caktuara nga ministria për njohjen e studentëve të ardhshëm mbi programin e studimit. Gjithashtu nga takimi me studentët GVJ konstatoi se përve ç ditëve informuese ata e kishin marrë inormacionin për degën nga faqia e internetit, rrjetet sociale, nga vizita në Universitet ose nga të afërm të tyre që kishin studiuar ose studionin në UAMD.<br><br>Evidenca nr 25. Urdheri dhe grupet e promovimit; https://uamd.edu.al/fakulteti-i-teknologjise-se-informacionit/; https://www.facebook.com/FTIUAMD |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se FTI/UAMD vë në dispozicion të studentëve të programit të studimit informacion të plotë e të hollësishëm mbi përparimin akademik, njohjen, vlerësimin e dijeve deri në përfundim të studimeve dhe diplomimit.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | Përmbushet pjesërisht | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

| **Standardi V.3** | |
|---|---|
| **Institucioni i arsimit të lartë vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit.** | |
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |

| | |
|---|---|
| **Kriteri 1.** Studentët informohen në mënyrë të hollësishme për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. | Nga takimet me Përgjegjesen e Departamentit dhe stafin akademik ne institucion u konstatua se studentet e viteve të para të cilët janë regjistruar ne programin e studimit profesionale 2-vjecarë "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik", por edhe të gjithë studentët e viteve të para të FTI/UAMD, në javën e parë të studimeve e kanë javë oreintuese. Gjatë kësaj jave studentët marrin informacion për instiucionin, si klasat e mësimit, biblioteka, sekretaria mësimore, etj, si edhe për programin e studimit për strukturën, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve. Këtë informacion tek studnetët e përcjellin pedagogët që janë të angazhuar në këtë program studimi.<br><br>Minutat e vizitës dhe takimet në institucion |
| **Kriteri 2.** Institucioni vë në dispozicion të studentëve informacion dhe dokumentacion/ udhëzues të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. | Sistemi Pitagora, faqja zyrtare e internetit dhe rrjetet sociale të FTI/UAMD janë disa nga format me anë të të cilave studentët informhen dhe gjejnë informacion të posaçëm për lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese. Gjithashtu një informacion të plotë për lendët studentët e marrin në javën e parë të zhvillimit të çdo moduli përkatës nga pedagogu i lëndës.<br><br>Sistemi Pitagora: https://uamd.edu.al/pitagora/;<br>Faqe Web: https://uamd.edu.al/aplikacion-Web-dizenjim-grafik/: lëndët/modulet, përmbajtjen dhe veprimtaritë formuese |
| **Kriteri 3.** Institucioni informon studentët mbi mundësitë e punësimit, si dhe mbështetjen institucionale për orientimin drejt dhe në tregun e punës. | Në UAMD është e ngritur dhe funksionon Sektori i Karrierës dhe Alumnit/ Eksperte pranë Drejtorsë së Administrimit dhe Shërbimeve Akademike. Ky sektor ka këto katër shërbime kryesore:<br>• Ofrimin tek studentët i informacioneve dhe trajneve (mbi situatën në tregun e punës, përgatitjen e CV-së profesionale, letrës së motivimit, aftësitë e buta, etj.).<br>• Integrimi i studentëve në përmirësimin e njohjes së cilësive të tyre (identifikimi i pikave të forta dhe të dobëta, ndërgjegjësimi për aftësitë e tyre).<br>• Ofrimi i mundësive për zhvillimin e kompetencave të tyre (duke marrë parasysh aftësitë e menaxhimit të karrierës).<br>• Njohjen me mundësitë e punësimit (oferta për punësim, praktika, vullnetarizëm).<br><br>Gjithashtu studentët mund të gjejnë informacion të hollësishëm në faqen zyrtare dhe tabelat informuese në institucion për kontaktin me këtë zyrë dhe aktivitet më të fundit rreth saj.<br><br>Faqe Web: https://uamd.edu.al/karriera/;<br>Vizita në institucion |
| **Kriteri 4.** Studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. | Gjatë javës së parë të orientimit të viteve të para studentëve u vihet në dispozicion informacion i gjerë dhe i përditësuar për zhvillimin dhe organizimin e procesit mësimor, logjistikën, infrastrukturën dhe shërbimet në funksion të realizimit të tij. Këtë iformacion studentët mund ta aksesojnë në vazhdimësi në tabelat informuese në institucion dhe në zyrat përkatëse ku sekretaria mësimore është njëra prej tyre.<br><br>Vizita në institucion;<br>Minutat e vizitës |
| **Kriteri 5.** Institucioni informon studentët mbi praktikat profesionale në kuadër të realizmit të programit të studimit, partnerët dhe institucionet bashkëpunuese ku parashikohen të realizohen, si dhe mundësitë e punësimit e mbështetjen | Programi i studimit profesionale 2-vjecarë "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik" nuk ka në kurrikulën e tij një lëndë për praktikë profesionale, por në lëndët karakterizuese të tij zhvillohen në laboraturet e FTI/UAMD praktika lëndore. Në këto praktika student ka mundësi të praktikojë njohurit e tij të marrë për lëndën nën asistimin e padagogëve të lëndës. Institucioni ka disa partnerët dhe institucionet bashkëpunuese të cilët angazhohen si staf me kohë të pjesshme, ofrojnë trajnime të herëpashershme në institucon, ofrojnë treg |

| | |
|---|---|
| institucionale për orientimin drejt e në tregun e punës. | pune për studnetët e diplomuar dhe studentët e programeve të tjera Bachelor dhe Master mund të kryejn praktikën profesionale.<br><br>Tabelat përmbledhëse, Tabela 5;<br>Syllabuese AWDG;<br>Takimet në institucion |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se FTI/UAMD vë në dispozicion të studentëve informacion të plotë e të hollësishëm për objektivat formuese, strukturën, organizimin, përmbajtjen e programit të studimit, rezultatet e pritshme të të nxënit dhe mundësitë e punësimit. Ai rekomandon mundësinë e përfshirjes së praktikës mësimorë si lëndë më vete në mundësi që studenti të mund të ketë një urë lidhëse me tregun e punës dhe ta njohi atë.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | **X** | |

| **Standardi V.4**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, si dhe të dhëna të punësimit të tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve. | Në FTI/UAMD studentët të cilët kanë fituar të drejtën për programin e studimit profesionale 2-vjecarë "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik" regjistrohen në Sekretarinë përkatëse, gjithashtu edhe në systemin elektronikë Pitagora. Kryesekrearia dhe sekretaria e degës përkatëse ka informacion për numrin e studentëve të regjistruar në programin e studimit, deri në diplomimin e tyre, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve. Në vizitën në institucion GVJ konstato se informacioni ruhej në kokementa elektronikë dhe regjistra të degëve, por ende nuk ishte në regjistrat e miratuara nga ASHR. Kërkesa është bërë për regjistra themeltar dhe janë në pritje për to.<br><br>Evidenca nr. 5. Rregullore IAL UAMD, Neni 42, Neni 56, Neni 57, Neni 58 dhe neni 59;<br>Sistemi Pitagora: https://uamd.edu.al/pitagora/; |
| **Kriteri 2.** Të dhënat statistikore të studentëve menaxhohen përmes sistemit të brendshëm të informacionit dhe duhet të jenë të sigurta dhe lehtësisht të verifikueshme nga personat e autorizuar. | FTI/UAMD përdor sistemi elekronik Pitagora, ku pedagogët, sekretaret dhe sutudnetët kanë profilet e tyre sipas autorizimeve përkatëse. Gjithashtu nga takimet në institucion deri në ardhjen e regjistrave themeltar sekretaria e degës dhe kryesekretaria raportonet listat dhe cdo nryshim në instacat më të larta drejtuese për to.<br><br>Sistemi Pitagora: https://uamd.edu.al/pitagora/;<br>Vizita në institucion;<br>Minutat e vizitës |
| **Kriteri 3.** Institucioni mbështet me akte, kontrollin periodik të përvitshëm pranë gjithë njësive përgjegjëse për menaxhimin (sekretaritë mësimore, sistemin e | Në UAMD Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPGSC) është struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. KPGSC, në rolin e një komisioni të përhershëm, kërkon në mënyrë të vazhdueshme informacione dhe raporte lidhur me çështjet e cilësisë dhe |

| | |
|---|---|
| menaxhimit të brendshëm të informacionit, etj.), vlerëson dhe dokumenton gjendjen dhe saktësinë e informacionit dhe të dokumentacionit që lidhet me studentët, dhe me veprimtarinë e tyre përkatëse. | programeve të studimit nga NjSBC.<br><br>Nga RVB cilësohet se: Në UAMD njësia kryesore, invstitucionie dhe në disa raste audite të jashtme nga mAS janë format e kontrollit të mbarvajtjes së punës në zbatimin me korrektësi të detyrave dhe kërkesave ligjore për menaxhimin e të dhënave të studentëve.<br><br>Evidenca nr. 17. Rregullore NJSBC;<br>RVB Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik;<br>Takimet në institucion |
| **Kriteri 4.** Njësia përgjegjëse për programin e studimit duhet të hartojë raporte analitike, periodike mbi profilin dhe cilësinë në hyrje dhe dalje të studentëve, si dhe shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, duke e shoqëruar me masat e duhura në drejtim të përmirësimit të këtyre treguesve. | Sekretaria mësimore disponon të dhëna për studnentë në hyrje dhe ata të diplomuar dhe ja kalon ato njësië përgjegjëse dhe zyrës së ALUMNIT. Nga takimet në institucion u konstatua se programi i studimit profesionale 2-vjecarë "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik" kishte të diplomuar brezin e parë të studentëve dhe ata ishin pak në numër 4 nga 54 të regjisturar në vitin akademik 2020-2021, kjo për arsye se një pjesë ishin ç'regjistruar 8 prej tyre dhe pjesa tjetër ende kishin kredite të pa marra. Zyra e ALUMNIT edhe nuk kishte krijuar një bazë të dhënash të polulluar me shkallën e cilësisë së punësimit të tyre, por ajo ruante kontake me ta përmes adresave të email-it ku i njoftonte për ofertat e reja të punës, organizonte trajnime të ndryshme për përgatitjen e tyre për tregun e punës si shkrimi i një CV, etj.<br><br>Tabela Permbledhese Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik, Tabela 21;<br>Vizita në institucion;<br>Minutat e vizitës |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se FTI/UAMD mbledh, administron, përditëson dhe ruan të dhëna të hollësishme në lidhje me numrin e profilin e studentëve që ndjekin programin e studimit, nga pranimi në diplomim, por ende nuk ka të dhëna për punësimin e tyre duke qënë se vetëm një brez studentësh është diplomuar.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [illegible] | **Përmbushet pjesërisht** | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | X | |

| **Standardi V.5**<br><br>**Institucioni i arsimit të lartë përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese, në kuadër të hartimit, miratimit, rishikimit e përmirësimit të programit të studimit, metodave të mësimdhënies dhe cilësisë së burimeve e shërbimeve ndaj tyre.** | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| **Kriteri 1.** Institucioni parashikon përfshirjen dhe angazhimin e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në organet vendimmarrëse e këshilluese sipas akteve ligjore dhe atyre rregullatore të vetë institucionit. | Sipas rregulloreve të UAMD dhe FTI studentët përfaqësohen në organet e UAMD-së, gjithashtu ata kanë të drejtë të marrin pjesë në të gjitha proceset e vendimmarrjes së FTI-së dhe UAMD-së, në përputhje me parashikimet ligjore dhe statutore. Në senatin akademik studentët përfaqsohen në masën 10%.<br><br>Evidenca nr. 5. Rregullore IAL UAMD, neni 115;<br>6. Rregullore FTI, neni 87;<br>2. STATUTI-MIRATUAR-UAMD, neni 14 |
| **Kriteri 2.** Institucioni duhet të | Sipas rregulloreve të UAMD dhe FTI studentët shprehin vlerësimin e tyre për |

| | |
|---|---|
| garantojë se përfshirja e studentëve dhe/ose përfaqësuesve të tyre në vendimmarrje, këshillim apo vlerësimin mbi procesin akademik, të jetë reale, konkrete, frutdhënëse dhe me rezultate lehtësisht të verifikueshme e të matshme. | cilësinë e mësimdhënies dhe punën e personelit akademik të universitetit, nëpërmjet vlerësimeve semestrale ose vjetore që organizohen nga njësitë e sigurimit të cilësisë. Nga takiment në isntitucion me studnetët, këto pyetësorë realizoheshin përpara provimeve dhe ishin anonime duke shprehur mendimin real të tyre.<br><br>Evidenca nr. 5. Rregullore IAL UAMD, neni 115;<br>6. Rregullore FTI, neni 87 |
| **Kriteri 3.** Njësia përgjegjëse garanton përfshirjen e studentëve në procesin e hartimit, rishikimit dhe përmirësimit të programit të studimit mbi baza të rregullta dhe reflekton sugjerimet e kontributin e tyre në to, në mbledhje të përbashkëta në departament, me pyetësorë, grupe fokusimi, etj. | Për programin e studimit profesionale 2-vjecarë "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik" nuk ka pasur ndryshime të programit mësimor dhe syllabuseve të tij, por mendimi i studnetëve është marrë në përshtatjen e orareve, provimeve dhe mësimdhënies.<br><br>Vizita në institucion;<br>RVB Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik] |
| **Kriteri 4.** Studentëve u mundësohet dhënia e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve, përfshirë mundësinë e ankimimit të rezultatit, rishikimit dhe reflektimit nga ana e institucionit/ njësisë/pedagogut përgjegjës. | Në rregulloret e UAMD dhe FTI janë të përcaktuar qartë mënyra e vlësimit të studentëve për vlerësimin përfudimtar duke ju mundësuar dhënien e mendimit mbi barazinë dhe ndershmërinë e kryerjes së procesit të vlerësimit dhe kontrollit të dijeve.<br><br>Në FTI/UAMD vlerësimi përfundimtar i çdo kursi kryhet duke u bazuar në shumën e pikëve të grumbulluara gjatë zhvillimit të kursit si më poshtë:<br><br>a. provimi i parë i ndërmjetëm, përmban 400 pikë ose 40% të vlerësimit përfundimtar;<br><br>b. provimi përfundimtar, përmban 500 pikë ose 50% të vlerësimit përfundimtar;<br><br>c. detyrat, projektet, esetë, përmbajnë 100 pikë ose 10% e vlerësimit përfundimtar.<br><br>GVJ konstatoi gjatë takimimeve në institucion me persolenin akademik dhe studentët respektimin e të drejtave të studentëve për rishikim dhe ankimim të mundshëm.<br><br>Takimet në institucion;<br>5. Rregullore IAL UAMD;<br>6. Rregullore FTI, neni 52 |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se FTI/UAMD përfshin dhe angazhon studentët në organet vendimmarrëse e këshilluese. Studneët kanë pëfaqësim në senat. Programin i studimit profesionale 2-vjecarë "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik" kishte senatorin përkatës.* |

| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | [redacted] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
|---|---|---|---|---|
| | | | | **X** |

**Standardi V.6**

**Institucioni i arsimit të lartë ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve, menaxhimin e ankimimeve e problematikave, të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë**

| të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët. | |
|---|---|
| **Kriteret** | **Vlerësimi** |
| Kriteri 1. Institucioni ka procedura e njësi të posaçme në shërbim të informimit e shërbimit të studentëve, në përputhje me parashikimet ligjore dhe aktet rregullatore të institucionit. | Në UAMD është ngritur dhe funkionon Komisioni i Përhershëm për Sigurimin e Brendshëm të Cilësisë (KPGSC) si struktura mbikëqyrëse, vlerësuese, miratuese dhe garantuese e standardeve të cilësisë së institucionit dhe e programeve të studimit. KPGSC mbikqyr dhe pranon raportet 3-mujore, 6-mujore dhe ato vjetore që përgatiten nga NjSBC dhe nëse gjykohet e nevojshme i kthen ato me sugjerime apo rekomandime për reflektim të mëtejshëm. Drejtoria e Kurrikulës dhe Sigurimit të Cilësisë është njësia përgjegjëse e cila organizonëë punën për kryerjen e procesit të vlerësimit dhe shpërndarjen e formularëve standardë për çështje të tilla si pyetesorët per studentët, administratën dhe stafin akademik, si dhe atyre alumni, bazuar në formatet e miratuara nga NjSBC dhe KPGSC dhe udhëzimet përkatëse.<br><br>Evidenca nr. 17 Rregullore NJSBC<br>Faqe Web: https://uamd.edu.al/ëp-content/uploads/2023/03/Rregullore-per-Sigurimin-e-Cilesise-E-rishikuar-1.pdf |
| Kriteri 2. Institucioni ka ngritur dhe ka bërë funksional një sistem të posaçëm për informimin, këshillimin, ndjekjen e përparimit të studentëve dhe ndihmesën e tyre për çështje që kanë të bëjnë me procesin mësimor dhe programin e studimit. | Sektorit të Karrierës dhe Alumnit fokusohen në katër shtylla kryesore:<br>• I ofron studentëve informacion dhe trajnim (mbi situatën në tregun e punës, përgatitjen e CV-së profesionale, letrës së motivimit, aftësitë e buta, etj.).<br>• I ofron studentëve mundësi për zhvillimin e kompetencave të tyre (duke marrë parasysh aftësitë e menaxhimit të karrierës).<br>• Njohja me mundësitë e punësimit (oferta për punësim, praktika, vullnetarizëm).<br>GVj nga takimi me studentët konstatoi se ata njoftoheshin here pas here nga Zyra e Karrirës dhe Alumndit për trajnime ose oferta punësimi.<br>Faqe Web: https://uamd.edu.al/karriera/ |
| **Kriteri 3**. Institucioni u ofron studentëve shërbimin e këshillimit të karrierës. Zyra/njësia për këshillimin e karrierës mirëpret studentët në mënyrë të vazhduar dhe periodike, duke ofruar informacion dhe orientim të posaçëm, në lidhje me kompletimin e procesit mësimor, zgjedhjen dhe orientimin për praktikën profesionale në institucione të tjera dhe orientimin në tregun e punës. | GVJ gjatë vizitave në institucion konstaton se FTI/UAMD përdorte disa forma të këshillimi të karrirës nga zyra përkatëse e Karrierës dhe Alumnit ku studentët mund të këshilloheshin, ju vinin njoftime me email për trajnimet e ofertat e punësimi, njoftoheshin në tabelat informaues në institucion me anë të tabelave informuese për trajnim si përgatitjen e CV-së profesionale ose me anë të faqes zyrtare të Web e rrjeteve sociale.<br><br>Takimet në institucion;<br>Minutat e takimeve |
| **Kriteri 4.** Zyra/njësia e karrierës ndjek studentët pas diplomimit, mbledh, përpunon e mban të dhëna mbi shkallën dhe cilësinë e punësimit të studentëve të programit të studimit dhe ua vë ato në dispozicion studentëve dhe organeve e | Zyra e Karrierës ende nuk kishte të dhëna për studentet e programin e studimit profesionale 2-vjecarë "Aplikacion Web dhe Dizenjim Grafik" duke qënë se ishte diplomuar vetëm një brezë studentësh dhe ata ishin të paktën në numër. |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| autoriteteve drejtuese përkatëse | Evidenca nr. 26. Te dhenat e studenteve AWDG | | | |
| **Konkluzione** | *GVJ konstaton se FTI/UAMD ka procedura e njësi të posaçme për pritjen, orientimin, këshillimin e studentëve të cilat ushtrojnë veprimtarinë në mënyrë të përhershme e janë lehtësisht të arritshme nga studentët në formë elektronike por edhe ambjentet përkatëse.* | | | |
| **Shkalla e përmbushjes së standardit** | [redacted] | [redacted] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | **X** | |

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| **Shkalla e përmbushjes së standardeve të fushës V** | [redacted] | [redacted] | **Përmbushet kryesisht** | **Përmbushet plotësisht** |
| | | | | **X** |

**Përfundime të Vlerësimit të programit të studimit me karakter professional ne "Aplikacion Ne Web Dhe Dizenjim Grafik" ofruar nga Universiteti "Aleksandër Moisiu" Durrës**

**Pikat e forta dhe afirmime**

1. Programi profesional 2- vjeçar "Aplikacion Ne Web Dhe Dizenjim Grafik" i orfurar nga FTI-UAMD, është një program studimi bashkëkohor që synon të formojë dhe të përgatisë specialistë në fushën e dizenjimit & krijimit të faqeve Web dhe dizenjimit grafik.
2. Personeli akademik efektiv i angazhuar ka eksperiencë në program të mëparshme të niveleve të tjera.
3. Programi i studimit gëzon mbështetje të mirë nga strukturat drejtuese.
4. Stafi është i angazhuar në projekte ndërkombëtare duke zhvilluar kështu mekanizma specifikë për mbështetjen dhe kualifikimin profesional në funksion të metodave bashkëkohore të mësimdhënies dhe përmirësimit të kurrikulës.
5. Institucioni ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi në drejtim të bashkëpunimit akademik dhe profesional brenda dhe jashtë vendit dhe prej këtyrë marrëveshjeve ka pasur rezultate konkrete.
6. Institucioni organizon veprimtari dhe aktivitete në mbështetje të programit të studimit (trajnime, leksionet e hapura, etj.)
7. Laboratorët ofrojnë kushte të përshtatshme për zhvillimin e lëndëve me karakter profesional.
8. Mundësi shumë të mira për pedagogët dhe studentët për përdorimin e disa platformave të bibliotekave on line.

**Pika të dobta**

1. Literaturat në programet lëndore janë në përgjithësi më të vjetra se 5 vite.
2. Stafi në përgjithësi është i ri dhe mjaft i përgatitur, por ngarkesa mësimore e tyre është shumë e lartë, mbi normën e lejuar.

**Rekomandime**

1. Rekomandojmë një rishikim të procesit të vlerësimit në mënyrë që studentët të ndiejnë një nivel më të lartë të motivimit në rrugën e tyre drejt suksesit akademik. Ky rishikim synon të inkurajojë pjesëmarrjen aktive të studentëve dhe të ndihmojë në zhvillimin e aftësive praktike në mënyrë më efektive.

2. Biblioteka të pasurohet më tepër me tekste bashkëkohorë për lëndët karakterizuese të programit.
3. Rekomandojmë vendosjen e një lënde të tillë si "Praktikë Profesionale" si dhe zhvendosjen e fokusit drejt Alumnit dhe institucioneve private me të cilat ka marrëveshje.
4. Sugjerojmë aktivizimin më tepër të stafit të ftuar, në mënyrë që ngarkesa e stafit efektiv të ulet.
5. Në proceset e vetëvlerësimit të brendshëm në FTI/UAMD, është e rëndësishme të sigurohen informacionet në përputhje me kriteret e akreditimit dhe të shoqërohen ato me dokumentacionin e nevojshëm si referencë. Strukturat përkatëse, të cilat janë përgjegjëse për këto dokumente zyrtare, duhet t'i bëjnë të disponueshme për grupet e vlerësimit këto informacion dhe të ndihmojnë në këtë proces të rëndësishëm.

**Evaluation's conclusions for the professional study program "Web Application and Graphic Design" provided by "Aleksandër Moisiu" University in Durrës**

**Strengths and Affirmations**

1. The 2-year professional program "Web Application and Graphic Design" offered by FTI-UAMD is a contemporary study program aimed at shaping and preparing specialists in the field of web design and graphic creation.
2. The engaged academic staff has previous experience in programs at different levels.
3. The study program receives strong support from the university's management structures.
4. The staff is involved in international projects, thereby developing specific mechanisms to support and professionally qualify in line with contemporary teaching methods and curriculum improvement.
5. The institution has signed cooperation agreements for academic and professional collaboration both domestically and internationally, resulting in tangible outcomes.
6. The institution organizes activities and events to support the study program, including training sessions and open lectures.
7. The laboratories provide suitable conditions for the development of professionally-oriented courses.
8. There are excellent opportunities for both educators and students to access various online library platforms.

**Weaknesses**

1. The course literature is generally more than 5 years old.
2. The staff, while generally young and well-prepared, faces a high teaching workload beyond the permissible norm.

**Recommendations**

1. We recommend a review of the assessment process to enhance student motivation towards academic success. This review should encourage active student participation and more effective development of practical skills.
2. The library should be enriched with contemporary texts related to the core subjects of the program.
3. Consider introducing a course such as "Professional Practice" and shifting focus towards alumni and private institutions with which agreements are in place.
4. Encourage more involvement of adjunct staff to reduce the workload on the core academic staff.
5. In the internal self-assessment processes at FTI/UAMD, it is crucial to ensure that information is aligned with accreditation criteria and is accompanied by the necessary documentation as a reference. The relevant structures responsible for these official documents should make this information available to the assessment groups and assist in this vital process.

**Shkalla e përmbushjes së standardeve të cilësisë së programit**

| FUSHAT E VLERËSIMIT | SHKALLA E PËRMBUSHJES SË STANDARDEVE TË FUSHËS | | | |
|---|---|---|---|---|
| | [illegible] | Përmbushen pjesërisht | Përmbushen kryesisht | Përmbushen plotësisht |
| I. OFRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| II. ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMIT TË STUDIMIT ME KARAKTER PROFESIONAL | | | | X |
| III. MËSIMDHËNIA, MËSIMNXËNIA, VLERËSIMI DHE KOMPETENCAT | | | | X |
| IV. BURIMET NJERËZORE, FINANCIARE, INFRASTRUKTURA, LOGJISTIKA PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT | | | | X |
| V. STUDENTËT DHE MBËSHTETJA E TYRE | | | | X |
| VLERËSIMI TËRËSOR | | | | X |